



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.26

2004

10 maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9209 datë 23.3.2004	Për legalizimin e shtesave në ndërtime	1295
Ligj nr.9212 datë 25.3.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare "Për kufizimin e përgjegjësive për reklamimet detare, 1976" dhe në protokollin e vitit 1996	1297
Ligj nr.9213 datë 1.4.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1947", e ndryshuar dhe në protokollin e kësaj Konvente, të vitit 1978, i ndryshuar	1311
Vendim i KM nr.227, datë 23.4.2004	Për transferimin në pronësi bashkisë së qytetit të Ersekës të mjediseve të ish-brigadës së këmbëtorisë dhe të degës së mobilizimit, të cilat janë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes"	1312
Vendim i KM nr.228, datë 23.4.2004	Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore	1312

Vendim i KM nr.231, datë 23.4.2004	Për disa shtesa në vendimin nr.393, datë 15.8.2002 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkodër-Kthesa Vau i Dejës (pjesë e segmentit rrugor Lezhë-Shkodër)”	1314
Vendim i KM nr.234, datë 16.4.2004	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, për përballimin e shpenzimeve buxhetore, për ngritjen dhe funksionimin e grupit të punës me ekspertë, për reformën në fushën e drejtësisë, "Komisioni i Reformës Ligjore"	1319
Vendim i GJK nr.8, datë 23.4.2004	Me objekt shfuqizimi i vendimeve nr.1618, datë 19.4.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.1138, datë 1.11.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1692, datë 17.10.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit), si antikushtetuese	1319
Vendim i GJK nr.9, datë 28.4.2004	Me objekt shfuqizimi i vendimeve nr.849, datë 21.10.1998 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.332, datë 5.7.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.83, datë 6.2.2002 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese	1323

LIGJ
Nr.9209, datë 23.3.2004

PËR LEGALIZIMIN E SHITESAVE NË NDËRTIME

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj ka objekt legalizimin e ndërtimeve, tërësisht ose karabina, me sipërfaqe më të madhe se projekti i miratuar me vendim të KRRT-ve të njëjësive të qeverisjes vendore.

Neni 2
Dokumentacioni dhe kriteret e legalizimit

Për kryerjen e procesit të legalizimit të shtesave në ndërtime, çdo subjekt juridik i interesuar duhet të plotësojë dokumentacionin dhe këto kriteret legalizimi:

1. Të ketë depozituar në njësinë vendore përkatëse, brenda datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, procesverbalin e përfundimit të karabinasë.

2. Objekti të jetë në përputhje me planet rregulluese të miratuara.

3. Të ketë zbatuar funksionet e mjediseve nën tokë të objektit në përputhje me lejen e ndërtimit.

4. Të garantojë qëndrueshmërinë konstruktive dhe estetike të objektit.

5. Të dorëzojë raportin e vlerësimit për anën teknike dhe konstruktive të ndërtesës ose të karabinasë, të hartuar nga dy konstruktorë të licencuar, të cilët t'i bëhet oponenca nga institute të specializuara, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit.

6. Të mos pengojë realizimin e studimeve të miratuara, të çdo niveli, dhe të mos përbëjë rrezik për njerëzit dhe mjedisin.

7. Të mos cenojë integritetin e monumenteve të kulturës.

8. Të shlyejë pranë njësisë vendore përkatëse detyrimet e mëposhtme:

a) 20 për qind të vlerës së investimit të sipërfaqes tej lejes së miratuar për banesa;

b) 50 për qind të vlerës së investimit të sipërfaqes tej lejes së miratuar për objekte të natyrave të tjera;

c) në rastet kur pika 3 është teknikisht e pazbatueshme, investitori paguan 100 për qind të vlerës së ndërtimit për sipërfaqen e miratuar si vend parkimi;

ç) taksat që lidhen me marrjen e lejes së ndërtimit, sipas përcaktimeve në dispozitat ligjore në fuqi.

9. Për sipërfaqet tej lejes së miratuar dhe jashtë kushteve të kontratës së lidhur me pronarin e truallit, ku është kryer ndërtimi, të paraqesë dokumentacionin e zgjidhjes së konflikteve me pronarin e truallit.

10. Për sipërfaqet tej lejes së miratuar, që kanë cenuar drejtpërdrejt ose tërthorazi pronësinë private kufitare, të paraqesë dokumentacionin e zgjidhjes së konflikteve për pronësinë dhe distancat urbane.

11. Për sipërfaqet tej lejes së miratuar, që kanë cenuar drejtpërdrejt ose tërthorazi pronësinë publike, të bëhet vlerësimi i sipërfaqes së truallit të cenuar, duke marrë për bazë mesataren e vlerës së shitblerjeve për zonën përkatëse që ka Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) në tre muajt e fundit nga data që bëhet kërkesa. Në bazë të çmimit të caktuar për vlerësimin e sipërfaqes së truallit, këshilli i njësisë vendore vendos për kalimin në pronësi private të sipërfaqes së pronës në favor të kërkuarit të legalizimit të sipërfaqes tej lejes së miratuar.

12. Vërtetim nga Policia Ndërtimore dhe njësia vendore përkatëse për shlyerjen ose mosshlyerjen e detyrimeve për ndryshimet në objekt. Gjjobat e paguara zbriten nga pagesat, që do të bëjë subjekti i interesuar.

13. Vërtetim nga dega e tatimeve, që konfirmon se subjekti ndërtues ka derdhur detyrimet tatimore për TVSH-në dhe tatimin mbi fitimin për shtesat që kërkohet të legalizohen.

Neni 3 Ndarja e të ardhurave

Të ardhurat e krijuara, sipas nenit 2 pika 8 shkronjat “a”, “b” dhe “c”, ndahen si më poshtë:

- 80 për qind për njësitë e qeverisjes vendore;
- 20 për qind për Buxhetin e Shtetit.

Neni 4 Strukturat përgjegjëse

Legalizimi i shtesave të ndërtimeve, të parashikuara nga ky ligj, kryhet nga njësia e urbanistikës e njësisë vendore përkatëse. Procedurat dhe mënyrat e realizimit të këtij procesi do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5 Dokumentet e legalizimit

1. Për rastet e shkeljeve në ndërtimet e papërfunduara, të cilat kanë sipërfaqe më të madhe se projekti i miratuar, pas kryerjes së procedurave të parashikuara në nenin 2, subjekti pajiset me leje të re ndërtimi, e cila përfshin edhe sipërfaqen e legalizuar dhe truallin funksional përkatës të shtuar.

2. Për rastet e shkeljeve në ndërtimet e përfunduara, pas kryerjes së procedurave të parashikuara në nenin 2, njësia e urbanistikës e pajis subjektin me dokumentin e legalizimit.

Për rastet e parashikuara në pikën 2 subjekti pajiset me dokumentin e legalizimit, sipas formularit (Legalizim shtesë) të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 6 Afatet

1. Pranimi i kërkesave është deri në 3 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Afati i plotësimit të dokumentacionit, të parashikuar në nenin 2 të këtij ligji, është deri në një vit nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
3. Brenda 6 muajve nga dorëzimi i dokumentacionit, njësia e urbanistikës e njësisë vendore duhet të vendosë për legalizimin ose jo të shtesave në ndërtime.

Neni 7
Përjashtime

Paragrafi i parë i pikës 11 të nenit 20 dhe paragrafi i dytë i nenit 54 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” nuk zbatohen për rastet që janë objekt i këtij ligji.

Neni 8
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4 dhe 5 të këtij ligji.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4214, datë 23.4.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9212, datë 25.3.2004

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE
“PËR KUFIZIMIN E PËRGJEGJËSIVE PËR REKLAMIMET DETARE, 1976”
DHE NË PROTOKOLLIN E VITIT 1996

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën Ndërkombëtare “Për kufizimin e përgjegjësive për reklamimet detare, 1976” .

Neni 2

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin e vitit 1996 të Konventës Ndërkombëtare “Për kufizimin e përgjegjësive për reklamimet detare, 1976” .

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4206, datë 14.4.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTË
MBI KUFIZIMIN E PËRGJEGJËSIVE PËR REKLAMIMET DETARE, 1976

Palët Kontraktuese në këtë Konventë,
mbështetur në dëshirën e përcaktimit me anën e marrëveshjes të disa rregullave uniforme lidhur me kufizimin për reklamimet detare,
vendosën të përfundojnë për këtë qëllim Konventën dhe si rrjedhim ranë dakord sa më poshtë:

KAPITULLI I
E DREJTA E KUFIZIMIT

Neni 1

Personat e ngarkuar me kufijtë e përgjegjësive

1. Pronarët e anijeve dhe shpëtuesit, si janë përcaktuar këtu më poshtë, mund të kufizojnë përgjegjësitë e tyre në përputhje me rregullat e kësaj Konvente për reklamimet e përmendura në nenin 2.

2. Termi “pronar anije” nënkupton pronarin, charteruesin, menaxherin dhe operatorin e një anije për lundrime detare.

3. “Shpëtues” nënkupton çdo person që jep shërbim në lidhje direkte me operacione shpëtimi. Operacionet e shpëtimit do të përfshijnë gjithashtu operacionet e përmendura në nenin 2 paragrafi 1(d), (e) dhe (f).

4. Në qoftë se ndonjë nga reklamimet e përmendura në nenin 2, është bërë kundrejt një personi për akt neglizhence ose faj të tij, përgjegjës është pronari i anijes ose shpëtuesi, një person i tillë ka të drejtën e kufizimit të përgjegjësive të parashikuar në këtë Konventë.

5. Në këtë Konventë përgjegjësia e një pronari do të përfshijë përgjegjësinë për një veprim të ndodhur kundrejt anijes.

6. Një siguries i përgjegjësive për reklamimet, që janë subjekt i kufizimeve në përputhje me rregullat e kësaj Konvente kanë të drejtën e përfitimeve të kësaj Konvente të njëjta sikur të siguronin veten e tyre.

7. Veprimi i apelimit të kufizimit të përgjegjësive nuk përbën një pranim të përgjegjësive.

Neni 2

Reklamimet që janë objekt i kufizimeve

1. Mbi bazën e neneve 3 dhe 4 do të jenë objekt i kufizimeve të përgjegjësive, pavarësisht se çfarë bazash përgjegjësie janë, reklamimet që vijnë:

a) Reklamimet në lidhje me humbjen e jetës ose plagosjen e personave, ose humbjen dhe dëmet e pronës (duke përfshirë edhe dëmet kundrejt punimeve portuale, baseneve, kanaleve dhe mjeteve ndihmëse për lundrimin) që ndodhin në bord ose në lidhje direkte me operacionin e anijes ose operacione shpëtimi, si dhe humbjet që rrjedhin nga këto.

b) Reklamimet në lidhje me humbjet, që rezultojnë nga vonesa për transportin detar të ngarkesës, të pasagjerëve ose të bagazheve të tyre.

c) Reklamimet në lidhje me humbjet që rezultojnë nga thyerja e të drejtave ose të drejtave kontraktuale, që ndodhin në lidhje direkte me operacionet e anijes ose operacione shpëtimi.

d) Reklamimet në lidhje me ngritjen, zhvendosjen, prishjen, bërjen të dëmshme të anijes, e cila është e mbytur, rënë në cekinë, e abandonuar, duke përfshirë çdo gjë që është ose ka qenë në bord të një anijeje të tillë.

e) Reklamimet në lidhje me zhvendosjen, prishjen ose bërjen të dëmshme të ngarkesës së anijes.

f) Reklamime të një personi, përveç atij personi që është përgjegjës në lidhje me masat e marra për të shmangur ose minimizuar humbjet për të cilat personi përgjegjës mund të kufizojë përgjegjësinë e tij sipas këtij kapitulli dhe humbjeve të tjera të shkaktuara nga masa të tilla.

2. Reklamimet e paragrafit (1) janë subjekt i kufizimit të përgjegjësisë edhe kur ngrihen me rekurs ose padi, sipas një kontrate ose ndryshe. Megjithatë, reklamimet e përmendura në paragrafin 1(d), (e) dhe (f) nuk do të jenë objekt i kufizimeve të përgjegjësisë në hapësirën që ato kanë në lidhje me vjeljen e të ardhurave sipas një kontrate me personat përgjegjës.

Neni 3

Reklamimet e përjashtuara nga kufizimet

Nenet e kësaj Konvente nuk do të zbatohen për sa vijon:

- a) Reklamimet për shpëtimin ose kontributin në një avari të përgjithshme;
- b) Reklamimet për dëmet nga ndotja me karburant, brenda kapitujve përkatës të CLOPD-së të datës 29 nëntor 1969 ose çdo amendamenti ose protokollit të saj, që është në fuqi;
- c) Reklamimet mbi bazën e çdo konvente ndërkombëtare ose të legjislacionit kombëtar që udhëheqin ose ndalojnë kufizimin e përgjegjësisë për dëmet nukleare;
- d) Reklamimet kundër pronarëve të anijeve nukleare, për dëmet nukleare;
- e) Reklamimet nga shërbyesit e pronarit ose shpëtuesi, detyrat e të cilëve lidhen direkt me anijen ose operacionet e shpëtimit, duke përfshirë reklamimet e vartësve dhe ndjekësve ose personave të tjerë të ngarkuar për të bërë reklamime të tilla, nëse sipas ligjit që mbështetet kontrata për shërbimin ndërmjet pronarit të anijes dhe shpëtuesit dhe shërbyesve të tillë që pronari i anijes ose shpëtuesi nuk është i ngarkuar që t'i kufizojë përgjegjësitë e tij lidhur me reklamime të tilla ose nëse ai është sipas ligjit të tillë i lejuar vetëm për kufizim të përgjegjësisë të tij për një shumë më të madhe se ajo e parashikuar në nenin 6.

Neni 4

Drejtimi i kufizimeve

Një person përgjegjës nuk do të jetë i ngarkuar për kufizimin e përgjegjësisë të tij, në rast se provohet që humbja rezulton nga veprime të tij, të shkaktuara me paramendim për të shkaktuar humbjet dhe me dijeninë që këto humbje do të ndodhin.

Neni 5

Kundërreklamimet

Kur një person i ngarkuar me kufizimin e përgjegjësisë sipas rregullave të kësaj Konvente, ka një reklamim kundër reklamuesit, që rezulton për të njëjtin shkak, reklamimet respektive të tyre do të pushojnë së qeni dhe parashikimet e kësaj Konvente do të zbatohen për balancim, në rast se ka.

KAPITULLI II

KUFIJTË E PËRGJEGJËSISË

Neni 6

Kufijtë e përgjithshëm

1. Kufizimet e përgjegjësisë për reklamimet, përveç atyre të përmendura në nenin 7 të ngritura në çfarëdo rasti të dallueshëm, do të llogariten si vijon:

- a) Lidhur me çdo reklamim për humbjen e jetës ose plagosje personi:
 - i) 333 000 njësi llogaritje për një anije me tonazh që nuk kalon 500 ton,
 - ii) për një anije që kalon madhësinë e përmendur më sipër, shumat që vijnë në plotësim të asaj të përmendur në paragrafin (i),

për çdo ton nga 5001 deri në 3 000 ton, 500 njësi llogaritje,
për çdo ton nga 3001 deri në 30 000 ton, 333 njësi llogaritje,
për çdo ton nga 30 001 deri në 70 000 ton, 250 njësi llogaritje dhe
për çdo ton në vazhdim mbi 70 000 ton 167 njësi llogaritje.

b) Lidhur me çdo reklamim tjetër:

i) 167 000 njësi llogaritje për një anije me tonazhe deri në 500 ton,

ii) për një anije që kalon madhësinë e përmendur më sipër, shumat që vijnë në plotësim të asaj të përmendur në paragrafin (i):

për çdo ton nga 501 deri në 30 000 ton, 167 njësi llogaritje,

për çdo ton nga 30 001 deri në 70 000 ton, 125 njësi llogaritje dhe

për çdo ton mbi 70 000 ton, 83 njësi llogaritje.

2. Kur vlera e përmendur në përputhje në paragrafin 1(a) është e pamjaftueshme për pagimin e plotë të reklamimit, vlera e llogaritur mbi bazën e paragrafit 1 (b) do të jetë e vlefshme për pagesën e pabalancuar të reklamimit në paragrafin 1(a) dhe një mospagesë e tillë e balancuar duhet të radhitet proporcionalisht me reklamimet e përmendura sipas paragrafit 1(b). Megjithatë, reklamimet në lidhje me dëmet në kalatat portuale, basenet dhe kanalet, si dhe mjetet ndihmëse për lundrimin do të kenë prioritet mbi të gjitha reklamimet e tjera sipas paragrafit 1 (b) të këtij neni.

3. Megjithatë, pa paragjykuar të drejtën e reklamimit për humbjen e jetës ose plagosjes së personit sipas paragrafit 2, një Shtet Palë mund të parashikojë në legjislacionin e tij kombëtar që reklamimet lidhur me dëmet ndaj kalatave, në basene dhe kanale, si dhe ndihmat për lundrim do të kenë prioritet mbi të gjitha reklamimet e tjera sipas paragrafit 1(b), siç parashikohet nga ai legjislacion.

4. Kufijtë e përgjegjësisë për çdo shpëtues që nuk operon nga ndonjë anije ose për çdo shpëtues që vepron i vetëm në një anije së cilës ose një lidhje me të cilën ai është duke i dhënë ndihmë do të llogaritet me një tonazh 1500 ton.

5. Për qëllimet e kësaj Konvente, tonazhi i anijes do të konsiderohet GT i llogaritur në përputhje me rregullat për përmasat e tonazhit që përmban aneksi I i Konventës Ndërkombëtare të përmasave të tonazhit të anijeve të vitit 1969.

Neni 7

Kufijtë e reklamimeve të pasagjerit

1. Në lidhje me reklamimet e ngritura për çdo rast të dallueshëm për humbjen e jetës ose plagosje të pasagjerëve të një anijeje, kufijtë e përgjegjësisë së pronarit do të jenë në një vlerë prej 46 666 njësi të llogaritura, shumëzuar me numrin e pasagjerëve që anija është e autorizuar të transportojë sipas certifikatës së anijes, por duke mos kaluar 25 milionë njësi llogaritje.

2. Për qëllimet e këtij neni, reklamim për humbjen e jetës ose plagosjes së pasagjerëve të një anijeje, nënkuptojmë çdo reklamim të ngritur nga ose në emër të çdo personi që anija transporton sipas:

a) një kontrate për transportin e pasagjerëve ose

b) për një person i cili me pëlqimin e transportuesit, është duke shoqëruar një automjet ose kafshë të gjalla, të cilat janë të mbuluara nga një kontratë transporti mallrash.

Neni 8

Njësia e llogaritur

1. Njësia e llogaritjes referuar në nenet 6 dhe 7 është një e drejtë tërheqje e veçantë e përcaktuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Shumat e përmendura në nenet 6 dhe 7 do të konvertohen në monedhën kombëtare të shtetit në të cilën kërkohet, sipas vlerës të kësaj monedhe në datën kur është krijuar fondi i kufizuar, pagesa është bërë ose është dhënë siguria e cila sipas ligjeve të këtij shteti është e barabartë me një pagesë të tillë. Vlera e monedhës kombëtare sipas termave të së drejtës së veçantë të tërheqjes, i një Shteti Palë, i cili është një anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar, do të llogaritet në përputhje me metodën e vlerësimit të zbatuar nga Fondi Monetar

1300

Ndërkombëtar në fuqi në datën në fjalë për operacionet dhe transaksionet e saj. Vlera e monedhës kombëtare sipas termave të së drejtës speciale të tërheqjes të një Shteti Palë i cili nuk është një anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar, do të llogaritet në një mënyrë të përcaktuar nga Shteti Palë.

2. Megjithatë, ato shtete që nuk janë anëtare të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe ligjet e të cilit nuk lejojnë zbatimin e parashikimeve të paragrafit 1, mundet në kohën e firmosjes pa rezerva si ratifikimi, pranimi ose miratimi ose në kohën e ratifikimit, pranimi, miratimi ose bashkimit, ose në çdo kohë më vonë, deklaron se kufijtë e përgjegjësisë të parashikuar në këtë Konventë zbatohen në territoret e tyre dhe do të fiksohen si vijon:

a) Lidhur me nenin 6 paragrafi 1(a) me një shumë prej:

i) 5 milionë njësi monedhe për një anije me tonazh që nuk i kalon 500 tonët;

ii) për një anije që kalon madhësinë e përmendur më sipër, shumat që vijnë në plotësim të asaj të përmendur në paragrafin (i):

për çdo ton nga 501 deri 3000 ton, 7500 njësi monedhe

për çdo ton nga 3001 deri 30 000 ton, 5000 njësi monedhe

për çdo ton nga 30 001 deri 70 000 ton, 3750 njësi monedhe dhe

për çdo ton mbi 70 000 ton, 2500 njësi monedhe.

b) Lidhur me nenin 6 paragrafi 1 (b), me një shumë prej:

i) 2.5 milionë njësi monedhe për një anije me tonazh deri në 500 ton;

ii) për një anije që kalon madhësinë e përmendur më sipër, shumat që vijnë në plotësim të asaj të përmendur në paragrafin (i),

për çdo ton nga 501 deri 30 000 ton, 2500 njësi monedhe

për çdo ton nga 30 001 deri 70 000 ton, 1850 njësi monedhe dhe

për çdo ton nga 70 000 ton, 1250 njësi monedhe.

c) Lidhur me nenin 7 paragrafi 1 me një shumë prej 700 000 njësi monedhe shumëzuar me numrin e pasagjerëve të cilët është e autorizuar anija t'i transportojë sipas certifikatës, por që nuk duhet të tejkalojë 375 milionë njësi monedhe.

Paragrafët 2 dhe 3 të nenit 6 zbatohen respektivisht ndaj nënparagrafit (a) dhe (b) të këtij paragrafi.

3. Njësia monedhe referuar në paragrafin 2 i korrespondon gjashtëdhjetë e pesë e gjysmë miligram flori me pastërti nëntëqind milesimal. Konvertimi i shumave referuar në paragrafin 2 në monedhën kombëtare duhet të bëhet sipas legjislacionit të shtetit të interesuar.

4. Llogaritjet e përmendura në fjalinë e fundit të paragrafit 1 dhe konvertimi i përmendur në paragrafin 3 duhen bërë në mënyrë të tillë që të shprehën në monedhë kombëtare të Shtetit Palë sa më afër të jetë e mundur me të njëjtën vlerë reale për shumat në nenet 6 dhe 7, siç janë shprehur aty në njësi llogarie. Shtetet Palë do t'i komunikojnë depozituesit mënyrën e llogaritjes në bazë të paragrafit 1 ose rezultatin e konvertimit në paragrafin 3, si të jetë rasti, në kohën e firmosjes pa rezerva për ratifikim, pranim ose miratim, ose kur depozitohet instrumenti i referuar në nenin 16 dhe kurdoherë që ka ndryshime.

Neni 9

Përmbledhja e reklamimeve

1. Kufijtë e përgjegjësisë të përcaktuara në përputhje me nenin 6 do të zbatohen në përmbledhjen e të gjitha reklamimeve të cilat ngrihen në çdo rast të dallueshëm si më poshtë:

a) Kundër personit ose personave të përmendur në paragrafin 2 të nenit 1 dhe çdo personi që për aktet, neglizhencën ose fajet e tyre janë përgjegjës.

b) Kundër pronarëve të anijes që jep shërbim shpëtimi nga anija dhe shpëtuesit ose shpëtuesve që operojnë nga anije të tilla dhe çdo personi që për aktet, neglizhencën ose fajet ai ose ata janë përgjegjës.

c) Kundër shpëtuesit ose shpëtuesve që nuk janë duke operuar nga një anije ose të cilët po operojnë të vetëm në anije, ose lidhur me të cilën, shërbimet e shpëtimit janë dhënë dhe kundrejt çdo personi që për aktet, neglizhencën ose fajet ai ose ata janë përgjegjës.

2. Kufijtë e përgjegjësive të përcaktuara në përputhje me nenin 7 do të zbatohen në përmblendhjen e të gjitha reklamimeve të cilat mund të ngrihen ose çdo rast i veçantë kundër personit ose personave të përmendur në paragrafin 2 të nenit lidhur me anijen referuar në nenin 7 dhe çdo personi që për aktet, neglizhencën ose fajin e tij ose të tyre, është ose janë përgjegjës.

Neni 10

Kufizimi i përgjegjësive pa formimin e fondit të kufizuar

1. Kufizimi i përgjegjësive mund të realizohet pa marrë parasysh që fondi i kufizuar si përmendet në neni 11 nuk është krijuar. Megjithatë, një Shtet Palë mund të parashikojë në legjislacionin e tij kombëtar, kur një veprim çohet në gjykatën e tij për të zbatuar një reklamim objekt i kufizimit, një person i ngarkuar mund të realizojë të drejtën për kufizimin e përgjegjësive nëse një fond i kufizuar është krijuar në përputhje me parashikimet e kësaj Konvente ose është krijuar kur e drejta për kufizimin e përgjegjësive është ngritur.

2. Në qoftë se kufizimi i përgjegjësive është ngritur pa krijuar fondin e kufizuar, respektivisht do të zbatohen parashikimet e nenit 12.

3. Çështjet e procedurave të ngritura sipas rregullave të këtij neni do të vendosen në përputhje me legjislacionin kombëtar të Shtetit Palë në të cilin veprimi është sjellë.

KAPITULLI III FONDI I KUFIZUAR

Neni 11

Krijimi i fondit

1. Çdo person i supozuar si përgjegjës mund të formojë një fond në gjykatë ose autoritetet e tjera kompetente të një Shteti Palë në të cilin zhvillohen procedurat ligjore lidhur me reklamat objekt i kufizimit. Fondi do të krijohet sipas shumave të vlerave të tilla të vendosura në nenet 6 dhe 7 si janë të zbatueshme ndaj reklamimeve për të cilat ky person mund të jetë përgjegjës, së bashku me interesat që rrjedhin nga data e ngjarjes që sjell ngritjen e përgjegjësive deri në datën e krijimit të fondit. Çdo fond i krijuar kështu do të jetë i vlefshëm vetëm për pagimin e reklamimeve lidhur me të cilat mund të ngrihen kufizimet e përgjegjësive.

2. Një fond mund të krijohet ose duke depozituar shumën, ose duke dhënë një garanci të pranueshme sipas legjislacionit të Shtetit Palë, kur fondi është krijuar dhe konsiderohet se është i përshtatshëm nga gjykata ose autoritetet e tjera kompetente.

3. Fondi i krijuar prej një nga personat e përmendur në paragrafin 1(a), (b) ose (c) ose paragrafi 2 i nenit 9 ose siguresit të tij do të konsiderohet i krijuar nga të gjithë personat e përmendur përkatësisht në paragrafin 1(a), (b) ose (c) ose paragrafin 2.

Neni 12

Shpërndarja e fondit

1. Mbështetur në parashikimet e paragrafëve 1, 2 dhe 3 të nenit 6 dhe nenit 7 fondi do të shpërndahet ndërmjet reklamuesve në proporcion të reklamimit të krijuar të tyre kundrejt fondit.

2. Në qoftë se, përpara shpërndarjes së fondit, personi përgjegjës ose siguresi i tij, ka vendosur një reklamim kundrejt fondit, një person i tillë, deri në shumën që ai ka paguar, do të fitojë të drejtat të cilat personi i kompensuar në mënyrë të tillë do t'i gëzohet sipas kësaj Konvente.

3. E drejta e anëtarësimit e parashikuar në paragrafin 2 mund të ushtrohet, gjithashtu nga personat, përveç atyre të përmendur lidhur me çdo shumë kompensimi të cilat ata mund t'i kenë paguar, por vetëm me kushtin që një anëtarësim i tillë lejohet nga legjislacioni në fuqi kombëtar.

4. Kur personi përgjegjës ose çdo person tjetër vendos se ai detyrohet të paguajë, në një datë të mëvonshme, komplet ose pjesërisht të çdo shume të tillë kompensimi lidhur se cilët nga personat të tillë do të gëzojnë të drejtën e anëtarësimit sipas paragrafëve 2 dhe 3 ka marrë kompensimin

përpara se fondi të shpërndahej, gjykata ose autoritetet e tjera kompetente të shtetit ku u krijua fondi mund të urdhërojnë që të vendoset menjëherë një shumë e mjaftueshme përkohësisht për të bërë të aftë persona të tillë në një datë të mëvonshme të marrin reklamimin e tyre kundrejt fondit.

Neni 13

Zhveshja ndaj veprimeve të tjera

1. Kur një fond kufizimesh është formuar në përputhje me nenin 11, çdo person që ka bërë një reklamim kundrejt fondit, do të zhvishet nga ushtrimi i çdo të drejte në lidhje me reklamime të tilla kundrejt çdo shifre tjetër të një personi nga ose në emër të të cilit fondi është formuar.

2. Pas formimit të fondit të kufizimeve në përputhje me nenin 11, çdo mjet lundruar ose pronë tjetër, që i përket një personi në emër të të cilit është formuar fondi, i cili është sekuestruar ose atashuar brenda juridiksionit të një Shteti Palë për një reklamim që mund të ngrihet kundrejt fondit, ose çdo sigurim i dhënë, mund të lirohet me urdhër të gjykatës ose autoriteteve të tjera kompetente të një shteti të tillë.

Megjithatë një lirim i tillë gjithmonë do të urdhërohet nëse fondi i kufizuar është krijuar:

a) në portin ku ka ndodhur ngjarja, ose kur ndodh jashtë portit si rrjedhim në portin e parë të prekjës;

b) në portin e zbarkimit në lidhje me një reklamim për humbje jete ose plagosje personi;

c) në portin e shkarkimit në lidhje me dëmet kundrejt ngarkesës;

d) në shtetin ku është bërë sekuestrimi.

3. Rregullat e paragrafëve 1 dhe 2 do të zbatohen vetëm për reklamuesit që ngrejnë reklamime kundrejt fondit të kufizimeve përpara një gjykate që administron këtë fond dhe ky fond është aktualisht i vlefshëm dhe i transferueshëm lirisht në lidhje me këtë reklamim.

Neni 14

Legjislacioni drejtues

Mbështetur në parashikimet e këtij kapitulli rregullat në lidhje me krijimin dhe shpërndarjen e fondit të kufizuar dhe të gjitha rregullat e procedurave në lidhje me to, do të udhëhiqen nga legjislacioni i Shtetit Palë në të cilin është krijuar fondi.

KAPITULLI IV

QËLLIMI I ZBATIMIT

Neni 15

Të përgjithshme

1. Kjo Konventë do të zbatohet kurdoherë që çdo person i referuar në nenin 1 kërkon që të kufizojë përgjegjësitë e tij përpara një gjykate të një Shteti Palë ose kërkon të bëjë procedurat për lirim e anijes ose pronave të tjera, ose të shkarkohet nga çdo siguri e dhënë brenda juridiksionit të çdo shteti të tillë. Megjithatë, secili Shtet Palë mund të përjashtojë komplet ose pjesërisht nga zbatimi i kësaj Konvente çdo person të referuar në nenin 1, i cili në kohën kur rregullat e kësaj Konvente janë futur para një gjykate të këtij shteti, nuk ka pasur banesë në një Shtet Palë ose nuk ka zyrtar kryesor të biznesit në një Shtet Palë, ose çdo anije për sa i përket së drejtës së kufizimit, e cila është futur ose lirim i tyre kërkohej dhe të cilat në kohën e specifikuar më sipër nuk kanë flamurin e Shtetit Palë.

2. Një Shtet Palë mund të rregullojë me parashikime të veçanta të legjislacionit kombëtar sistemin e kufizimit të përgjegjësisë të zbatueshme nga anijet që janë:

a) në përputhje me legjislacionin e këtij shteti, anijet e menduara për lundrim në ujërat e brendshme;

b) anijet me tonazh më pak se 300 ton.

Shteti Palë i cili përdor opsionet e parashikuara në këtë paragraf, do të njoftojë depozituesin për kufijtë e përgjegjësisë të adoptuara në legjislacionin e tij ose për faktin se nuk ka të tilla.

3. Një Shtet Palë mund të rregullojë me rregulla të veçanta të legjislacionit kombëtar sistemin e kufizimit të përgjegjësisë që do të zbatohet ndaj reklamimeve të ngritura në rastet kur janë përfshirë dhe interesat e personave që janë qytetarë të një Shteti tjetër Palë.

4. Gjykata e një Shteti Palë nuk do ta zbatojë këtë Konventë ndaj anijeve të ndërtuara, të adoptuara ose që angazhohen me shpime:

a) kur ky shtet ka formuar sipas legjislacionit të tij kombëtar një kufi më të lartë përgjegjësie se ai i përmendur në nen, ose

b) kur ky shtet bëhet palë në një konventë ndërkombëtare që rregullon sistemin e përgjegjësisë lidhur me anije të tilla.

Në rastin kur zbatohet nënparagrafi (a), atëherë ky Shtet Palë do të njoftojë depozituesin respektivisht.

5. Kjo Konventë nuk do të zbatohet:

a) për mjete me jastëk ajri;

b) për platforma lundruese të ndërtuara për qëllime të eksplorimit ose shfrytëzimit të burimeve natyrore të shtratit të detit ose nëntokës.

KAPITULLI V KLAUZOLAT PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Firmosja, ratifikimi dhe aderimi

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për firmosje nga të gjitha shtetet në Zyrat e Organizatës Ndërkombëtare Detare (këtu më poshtë të referuar “Organizata”) nga 1 shkurti 1977 deri më 31 dhjetor 1977, dhe më vonë si rrjedhim do të jetë e hapur për bashkim.

2. Të gjitha shtetet mund të bëhen palë në këtë Konventë me:

a) firmosjen pa rezerva për sa i përket ratifikimit, pranimi ose miratimit, ose

b) firmosjes me objekt ratifikimin, pranimin ose miratimin të ndjekur nga ratifikimi, pranimi ose miratimi, ose

c) aderimin.

3. Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi do të realizohen me anën e një dokumenti formal për këtë qëllim dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës (këtu më poshtë referuar si “Sekretari i Përgjithshëm”).

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pas një viti pas datës kur dymbëdhjetë shtete ose kanë firmosur pa rezerva atë për sa i përket ratifikimit, pranimi ose miratimit, ose datë kur ato kanë depozituar instrumentin formal të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit.

2. Për një shtet i cili depoziton një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi ose firmos pa rezerva lidhur me ratifikimin, pranimin, miratimin, në lidhje me këtë Konventë, pasi kërkesat për hyrjen në fuqi janë plotësuar, por përpara datës së hyrjes në fuqi, ratifikimi, pranimi miratimi ose bashkimi ose firmosja pa rezerva e ratifikimit, pranimi ose miratimit do të hyjë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të Konventës ose në ditën e parë të muajit që vjen pas nëntëdhjetë ditësh nga firmosja ose depozitimi i instrumentit kushdoqoftë data më e vonshme.

3. Për çdo shtet i cili bëhet palë në këtë Konventë, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që vjen pas skadimit të nëntëdhjetë ditëve nga data kur ky shtet ka depozituar instrumentin e tij.

4. Për sa i përket marrëdhënieve ndërmjet shteteve që ratifikojnë, pranojnë ose miratojnë këtë Konventë, ose aderojnë në të, kjo Konventë do të zëvendësojë dhe abrogojë Konventën Ndërkombëtare lidhur me kufizimin e përgjegjësive të pronarëve të anijeve detare të bërë në Bruksel më 10 tetor 1957 dhe Konventën Ndërkombëtare për unifikimin e disa rregullave lidhur me kufizimin e përgjegjësive të pronarëve të anijeve detare, të firmosura në Bruksel më 25 gusht 1924.

Neni 18

Rezervat

1. Çdo shtet në kohën e firmosjes, ratifikimit, pranimit, miratimit ose e aderimit, rezervon të drejtën të përjashtojë zbatimin e nenit 2 paragrafi 1(d) dhe (e). Asnjë rezervë tjetër nuk pranohet për parashikimet thelbësore të kësaj Konvente.

2. Rezervat e bëra në kohën e firmosjes janë subjekt i konfirmimit me ratifikimin, pranimin ose miratimin.

3. Çdo shtet i cili ka shprehur rezerva ndaj kësaj Konvente mund të mos e pranojë atë në çdo kohë, duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm. Mospranime të tilla hyjnë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit. Nëse njoftimi deklaron se mospranimi do të hyjë në fuqi në një datë të caktuar dhe kjo datë është më vonë e marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm, mospranimi do të hyjë në fuqi në këtë datë të mëvonshme.

Neni 19

Denoncimi

1. Kjo Konventë mund të denoncohet nga një Shtet Palë në çdo kohë pas një viti nga data në të cilën Konventa hyri në fuqi për këtë palë.

2. Denoncimi do të kryhet me anën e depozitimit të një instrumenti tek Sekretari i Përgjithshëm.

3. Denoncimi do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që vjen pas kalimit të një viti nga data e depozitimit të instrumentit ose pas një periudhe më të gjatë të tillë siç mund të jetë specifikuar në instrument.

Neni 20

Rishikimi dhe amendimi

1. Me qëllim amendimin ose rishikimin e kësaj Konvente mund të mbledhet një konferencë nga Organizata.

2. Organizata do të thërrasë një konferencë të Shteteve Palë të kësaj Konvente për rishikimin ose amendimin e saj me kërkesën e jo më pak se një të tretës së palëve.

3. Pas datës së hyrjes në fuqi të një amendamenti ndaj kësaj Konvente çdo instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose bashkimi i depozituar do të konsiderohet sikur zbatohet Konventa me gjithë amendamentet, përveçse kur ka të shprehur një mendim tjetër në instrument.

Neni 21

Rishikimi i shumave të kufizimeve dhe njësisë së llogaritjes ose njësisë monetare

1. Pa marrë parasysh parashikimin e nenit 20, një konferencë vetëm për qëllimet e ndryshimit të shumave të specifikuara në nenet 6, 7 dhe në nenin 8 paragrafi 2, ose të zëvendësimit të njëres ose të dyjave njësisë të përcaktuara në nenin 8 paragrafi 1 dhe 2, me njësi të tjera, do të mbledhet nga Organizata në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni. Një ndryshim i shumave do të bëhet vetëm për arsye të ndryshimeve thelbësore në vlerat reale të tyre.

2. Organizata do të thërrasë këtë konferencë pas kërkesës të jo më pak se një e katërta e Shteteve Palë.

3. Vendimi për ndryshimin e shumave ose zëvendësimin e njërive me njësi të tjera llogaritëse do të merret prej dy të tretave të Shteteve Palë që janë prezente dhe votojnë në një konferencë të tillë.

4. Çdo shtet që depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose bashkimit me Konventën, pas hyrjes në fuqi të një amendamenti, do të zbatojnë Konventën e amenduar.

Neni 22 Depozitimi

1. Kjo Konventë do të depozitohet tek Sekretari i Përgjithshëm.

2. Sekretari i Përgjithshëm:

a) Do t'ua transmetojë kopjet e vërteta të vërtetuara të kësaj Konvente të gjitha shteteve të cilat ishin ftuar për të ndjekur konferencën për kufizimin e përgjegjësisë të reklamimeve detare dhe shteteve të tjera të cilat i bashkohen kësaj Konvente.

b) Do të informojë të gjitha shtetet të cilat kanë firmosur ose janë bashkuar me këtë Konventë për:

i) secilën firmosje të re, secilin depozitim të një instrumenti dhe për çdo rezervë së bashku me datën e paraqitjes;

ii) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente ose të çdo amendamenti;

iii) çdo denoncim të kësaj Konvente dhe datën në të cilin ai hyn në fuqi;

iv) çdo amendament të adoptuar në përputhje me nenet 20 ose 21;

v) çdo komunikim të kërkuar për çdo nen të kësaj Konvente.

3. Me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente, një kopje e vërtetë e vërtetuar do t'i transmetohet Sekretarit të Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe publikim në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 23 Gjuhët

Kjo Konventë është bërë në një origjinal të vetëm në gjuhët angleze, franceze, ruse dhe spanjolle, duke qenë çdo tekst autentikisht i barabartë.

Bërë në Londër, më 19.11.1976

Si dëshmi nënshkruesi i autorizuar për këtë qëllim firmos këtë Konventë.

PROTOKOLLI I AMENDUAR KONVENTËS PËR KUFIZIMIN E PËRGJEGJËSIVE PËR REKLAMIMET DETARE TË 19 NËNTORIT 1976

Palët e pranishme në protokollin aktual,

duke konsideruar që është i dëshirueshëm amendimi i Konventës për kufizimin e përgjegjësisë të reklamimeve detare, bërë në Londër më 19 nëntor 1976, për të zmadhuar kompensimin dhe të krijimit të procedurave të thjeshta për të rinovuar shumat e kufizimit, ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllimet e këtij protokoll:

1. “Konventë” nënkupton Konventën “Për kufizimin e përgjegjësisë të reklamimeve detare, 1976”.

2. “Organizatë” nënkupton Organizatën Ndërkombëtare Detare.

3. “Sekretar i Përgjithshëm” nënkupton Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës.

Neni 2

Neni 3 nënparagrafi (a) i kësaj Konvente zëvendësohet nga teksti që:

a) Reklamimet për shpëtimin, duke përfshirë nëse është e zbatueshme, çdo reklamim për kompensim special sipas nenit 14 të Konventës Ndërkombëtare mbi shpëtimin 1989, të amenduar ose kontributin në avarinë e përgjithshme.

Neni 3

Neni 6 paragrafi 1 i kësaj Konvente zëvendësohet nga teksti që vijon:

1. Kufijtë e përgjegjësisë për reklamimet, përveç atyre të përmendura në nenin 7, të ngritura në çdo rast të dallueshëm, do të llogariten si vijon:

a) Në lidhje me reklamimet për humbje jete ose plagosje personale:

i) 2 milionë njësi llogaritje për një anije që nuk kalon 2000 tonët,

ii) për një anije me një tonazh mbi 2000 ton, shuma që vijon në plotësim të asaj të përmendur në (i):

për çdo ton nga 2001 deri 30 000 ton, 800 njësi llogarie,

për çdo ton nga 30 001 deri 70 000 ton, 600 njësi llogarie dhe

për çdo ton mbi 70 000 ton, 400 njësi llogarie.

b) Në lidhje me çdo reklamim tjetër:

i) 1 milion njësi llogaritje për një anije që nuk kalon 2000;

ii) për një anije me një tonazh mbi 2000 ton, shuma që vijon në plotësim të asaj të përmendur në (i):

për çdo ton nga 2 001 deri 30 000 ton, 400 njësi llogarie

për çdo ton nga 30 001 deri 70 000 ton, 300 njësi llogarie dhe

për çdo ton mbi 70 000 ton, 200 njësi llogarie.

Neni 4

Neni 7 paragrafi 1 i Konventës zëvendësohet me tekstin që vijon:

1. Në lidhje me reklamimet e ngritura në çdo rast të veçantë për humbjen e jetës ose plagosje personale të ndonjë pasagjeri në anije, kufiri i përgjegjësisë së pronarit të anijes do të jetë shuma prej 175 000 njësi llogarie e shumëzuar me numrin e pasagjerëve të cilët anija është e autorizuar t'i transportojë në përputhje me certifikatën e anijes.

Neni 5

Neni 8 paragrafi 2 i Konventës zëvendësohet nga teksti si vijon:

2. Megjithatë, ato shtete të cilat nuk janë anëtare të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe legjislacioni i të cilave nuk lejon zbatimin e parashikimeve të paragrafit 1 may, në kohën e firmosjes pa rezerva për ratifikim, pranim, miratim ose bashkim ose në çdo kohë pas kësaj, mund të deklarojnë që kufiri i përgjegjësisë i parashikuar në këtë Konventë që do të zbatohet në territoret e tyre do të fiksohet si vijon:

a) Në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 (a), në një shumë prej:

i) 30 milionë njësi monetare për një anije që nuk kalon 2000 ton;

ii) për një anije me një tonazh mbi 2000 ton, shuma që vijon në plotësim të asaj të përmendur në (i):

për çdo ton nga 2001 deri 30 000 ton, 12 000 njësi monetare,

për çdo ton nga 30 001 deri 70 000 ton, 9000 njësi monetare dhe

për çdo ton mbi 70 000 ton, 6 000 njësi monetare.

b) Në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 (b), në një shumë prej:

i) 15 milionë njësi monetare për një anije me tonazh që nuk i kalon 2000 tonët;

ii) për një anije me një tonazh mbi 2000 ton, shuma që vijon në plotësim të asaj të përmendur në (i):

për çdo ton nga 2 001 deri 30 000 ton, 6000 njësi monetare;

për çdo ton nga 30 001 deri 70 000 ton, 4 500 njësi monetare dhe

për çdo ton mbi 70 000 ton, 3 000 njësi monetare.

c) Në lidhje me nenin 7 paragrafi 1, në një shumë prej 2 625 000 njësi monetare, shumëzuar me numrin e pasagjerëve të cilët anija është e autorizuar t'i transportojë në përputhje me certifikatën e saj.

Paragrafët 2 dhe 3 të nenit 6 zbatohen respektivisht tek nënparagrafët (a) dhe (b) të këtij paragrafi.

Neni 6

Teksti që vijon shtohet si paragrafi 3 bis në nenin 15 të Konventës:

3 bis. Pa marrë parasysh kufijtë e përgjegjësisë të përshkruar në paragrafin 1 të nenit 7, një Shtet Palë mund të rregullojë me anën e parashikimeve të veçanta të legjislacionit kombëtar sistemin e përgjegjësisë që zbatohet për reklamimet për humbjen e jetës ose plagosjen personale të pasagjerëve në një anije, me kusht që ky kufi i përgjegjësisë të mos jetë më i ulët se ai i përshkruar në paragrafin 1 të nenit 7. Një Shtet Palë, i cili përdor opsionin e parashikuar në këtë paragraf, do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm për kufijtë e përgjegjësisë të adoptuar ose për faktin e mosekzistencës së tyre.

Neni 7

Neni 18 paragrafi 1 i Konventës zëvendësohet nga teksti që vijon:

1. Çdo shtet mundet, në kohën e firmosjes ratifikimit, pranimit, miratimit ose bashkimit, ose në çdo kohë më vonë, rezervon të drejtën:

a) të përjashtojë zbatimin e nenit 2 paragrafët 1(d) dhe (e);

b) të përjashtojë reklamimet për dëmet brenda kuptimit të Konventës Ndërkombëtare për përgjegjësitë dhe kompensimin për dëmet në lidhje me transportin e substancave helmuese dhe të rrezikshme me det, 1996 ose çdo amendament ose protokoll.

Asnjë rezervë nuk do të pranohet ndaj parashikimeve thelbësore të kësaj Konvente.

Neni 8

Amendimi i kufijve

1. Me kërkesën e së paku gjysmës, por në asnjë rast më pak se të gjashtë Shteteve Palë në këtë protokoll, çdo propozim për amendimin e kufijve të specifikuar në nenin 6 paragrafi 1, nenin 7 paragrafi 1 dhe nenin 8 paragrafi 2 të Konventës të amenduar në këtë protokoll, do t'u qarkullohet nga Sekretari i Përgjithshëm të gjithë anëtarëve të organizatës dhe të gjitha Shteteve Kontraktuese.

2. Çdo amendament i propozuar dhe i qarkulluar si më sipër do t'i parashtrahet Komisionit Ligjor të Organizatës (Komiteti Ligjor) për t'u marrë në konsideratë të paktën gjashtë muaj pas datës së qarkullimit të tij.

3. Të gjitha Shtetet Kontraktuese të Konventës, së bashku me protokollin si është amenduar, pavarësisht në janë ose jo anëtarë të Organizatës, do të kenë të drejtën e pjesëmarrjes në procedurat e Komitetit Ligjor për marrjen në konsideratë dhe adoptimin e amendamenteve.

4. Amendamentet do të adoptohen me dy të tretat e Shteteve Kontraktuese të Konventës, së bashku me protokollin e amenduar, që janë të pranishëm dhe votojnë në Komitetin Ligjor të zgjeruar si parashikohet në paragrafin 3, me kushtin që së paku gjysma e Shteteve Kontraktuese të Konventës, së bashku me këtë protokoll të amenduar të jetë e pranishme në kohën e votimit.

5. Kur vepron për një propozim për amendim të kufijve, Komiteti Ligjor duhet të marrë në konsideratë eksperiencën e incidenteve dhe, në veçanti, shumën e dëmit, që rezultojnë si rrjedhim, ndryshimet në njësitë monetare dhe efektin e amendamentit të propozuar në koston e sigurimit.

6. a) Asnjë amendament i kufijve sipas këtij neni do të merret parasysh më pak se 5 vjet nga data në të cilën ky protokoll është hapur për firmosje dhe as pas pesë vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të një amendamenti të mëparshëm sipas këtij neni.

b) Asnjë kufi nuk mund të rritet aq sa të kalojë shumën e cila i korrespondon kufirit të paraqitur në Konventë së bashku me këtë protokoll të amenduar, i rritur me 6 për qind në vit, llogaritur mbi bazat e përbërjes nga data në të cilën ky protokoll është i hapur për firmosje.

c) Asnjë kufi nuk mund të rritet aq sa të kalojë shumën që i korrespondon kufirit të paraqitur në Konventë, së bashku me protokollin shumëzuar me tre.

7. Çdo amendament i adoptuar në përputhje me paragrafin 4, do t'u njoftohet nga Organizata të gjitha Shteteve Kontraktuese. Amendamenti do të konsiderohet i pranuar në fund të periudhës prej tetëmbëdhjetë muajsh pas datës së njoftimit, derisa brenda kësaj periudhe jo më pak se një e katërta e shteteve që ishin Shtete Kontraktuese në kohën e adoptimit të amendamentit i kanë komunikuar Sekretarit të Përgjithshëm që ato nuk e pranojnë amendamentin në këtë rast amendamenti hidhet poshtë dhe nuk do të ketë asnjë fuqi.

8. Një amendament që duket se është pranuar në përputhje me paragrafin 7 do të hyjë në fuqi tetëmbëdhjetë muaj pas pranimi të tij.

9. Të gjitha Shtetet Kontraktuese do të zbatojnë amendamentin derisa ato ta denoncojnë këtë protokoll në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 12 së paku gjashtë muaj përpara se amendamenti të hyjë në fuqi. Denoncim i tillë do të hyjë në fuqi kur amendamenti të hyjë në fuqi.

10. Kur një amendament është adoptuar, por periudha prej tetëmbëdhjetë muajsh për pranimin e tij nuk ka përfunduar, një shtet i cili bëhet një Shtet Kontraktues pas kësaj periudhe do të zbatojë amendamentin i cili është pranuar në përputhje me paragrafin 7. Në rastet e referuara në këtë paragraf, një shtet zbaton një amendament, kur amendamenti hyn në fuqi ose kur ky protokoll hyn në fuqi për këtë shtet, nëse është më vonë.

Neni 9

1. Konventa dhe ky protokoll, ndërmjet palëve të këtij protokoll, do të lexohet dhe interpretohet si një instrument i vetëm.

2. Një shtet i cili është palë në Konventë do të zbatojë parashikimet e Konventës të amenduara nga ky protokoll në lidhje me Shtetet e tjera Palë, por nuk do të zbatojnë parashikimet e Konventës në lidhje me Shtetet Palë vetëm të Konventës.

3. Konventa e amenduar në këtë protokoll do të zbatohet vetëm për reklamimet e ngritura jashtë ngjarjeve të cilat ndodhin pas datës së hyrjes në fuqi për secilin shtet të këtij protokoll.

4. Asgjë e këtij protokoll nuk do të ndikojë në detyrimet e një shteti i cili është palë në të dyja, si në Konventë, ashtu dhe në protokoll lidhur me një shtet i cili është palë në Konventë, por jo palë në këtë protokoll.

KLAUZOLA PËRFUNDIMTARE

Neni 10

Firmosja, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe bashkimi

1. Ky protokoll do të jetë i hapur për firmosje në selinë e Organizatës nga 1 tetor 1996 deri më 30 shtator 1997 nga të gjitha shtetet.

2. Çdo shtet mund të shprehë konsensusin e tij për zbatimin e këtij protokoll:

a) të firmosë pa asnjë rezervë për ratifikim, pranim ose miratim, ose

b) firmosje me objekt ratifikimin, pranimin ose miratimin e ndjekur nga ratifikimi, pranimi, ose miratimi, ose

c) bashkimi.

3. Ratifikimi, pranimi, miratimi ose bashkimi do të hyjnë në fuqi me anën e depozitimit të një instrumenti për këtë qëllim te Sekretari i Përgjithshëm.

4. Çdo instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose bashkimi i depozituar pas hyrjes në fuqi të një amendamenti ndaj Konventës si amendohet nga ky protokoll do të konsiderohet si zbatim i Konventës të amenduar, të modifikuar nga një amendament i tillë.

Neni 11 **Hyrja në fuqi**

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë pas datës në të cilën dhjetë shtete kanë shprehur konsensusin e tyre për zbatimin e tij.

2. Për çdo shtet i cili ka shprehur konsensusin e tij për zbatimin e këtij protokoll pasij të jenë përmbushur kushtet e paragrafit 1 për hyrjen në fuqi, ky protokoll do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë pas datës së shprehjes të konsensusit të tillë.

Neni 12 **Denoncimi**

1. Ky protokoll mund të denoncohet nga çdo Shtet Palë në çdo kohë pas datës në të cilën ai hyn në fuqi për atë Shtet Palë.

2. Denoncimi do të zbatohet me anën e depozitimit të një instrumenti denoncimi te Sekretari i Përgjithshëm.

3. Një denoncim do të hyjë në fuqi pas dymbëdhjetë muajsh ose një periudhe të tillë më të gjatë si mund të jetë specifikuar në instrumentin e denoncimit, pas depozitimit të tij te Sekretari i Përgjithshëm.

4. Nëse ndërmjet Shteteve Palë në këtë protokoll bëhet denoncimi i Konventës në përputhje me nenin 19, kjo nuk do të merret në asnjë mënyrë si denoncim i Konventës së bashku me këtë protokoll të amenduar.

Neni 13 **Rishikimi dhe amendimi**

1. Për qëllimet e rishikimit ose amendimit të këtij protokoll mund të mbledhet një konferencë nga Organizata.

2. Organizata do të thërrasë një konferencë të Shteteve Kontraktuese të këtij protokoll për rishikim ose amendim të tij me kërkesën e jo më pak se një të tretës të Shteteve Kontraktuese.

Neni 14 **Depozitimi**

1. Ky protokoll dhe çdo amendament i adoptuar sipas nenit 8 do të depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm.

2. Sekretari i Përgjithshëm:

a) Duhet të informojë të gjitha shtetet të cilat kanë firmosur ose kanë hyrë në këtë protokoll për:

i) secilën firmosje të re ose depozitim të një instrumenti së bashku me datën e tij;

ii) secilën deklaratë dhe komunikim sipas nenit 8 paragrafi 2 i Konventës të amenduar nga ky protokoll dhe nenit 8 paragrafi 4 i Konventës;

iii) datën e hyrjes në fuqi të këtij protokoll;

iv) çdo propozim për amendim kufijsh, i cili është bërë në përputhje me nenin 8 paragrafi 1;

v) çdo amendament i cili është adoptuar, në përputhje me nenin 8 paragrafi 4;

vi) çdo amendament i cili duket si i pranuar sipas nenit 8 paragrafi 7 së bashku me datën në të cilën amendamenti hyn në fuqi, në përputhje me paragrafin 8 dhe 9 të këtij neni;

vii) depozitimin e çdo instrumenti denoncimi ndaj këtij protokoll, së bashku me datën e depozitimit dhe datën në të cilën hyn në fuqi;

b) Duhet t'ua transmetojë kopjet e vërteta të vërtetuara të këtij protokollit të gjitha shteteve firmosëse dhe të gjitha shteteve të cilat bashkohen me protokollin.

3. Sa më shpejt që ky protokoll hyn në fuqi, teksti do t'i transmetohet nga Sekretari i Përgjithshëm, Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe publikim, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 15

Gjuhët

Ky protokoll është në një origjinal të vetëm në gjuhët arabisht, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht, duke qenë çdo tekst autentikisht i barabartë.

Bërë në Londër, më 2.5.1996

Si dëshmi nënshkruesit duke qenë të autorizuar nga qeveritë e tyre respektive, firmosën këtë protokoll.

LIGJ

Nr.9213, datë 1.4.2004

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE
DETARE “PËR SHPËTIMIN E JETËS NË DET (SOLAS), 1947”, E NDRYSHUAR DHE NË
PROTOKOLLIN E KËSAJ KONVENTE, TË VITIT 1978, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën Ndërkombëtare Detare “Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1947”, e ndryshuar.

Neni 2

Republika e Shqipërisë aderon në “Protokollin e vitit 1978, i ndryshuar, të Konventës Ndërkombëtare Detare “Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1974”, e ndryshuar.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4210, datë 26.4.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

VENDIM
Nr.227, datë 23.4.2004

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI BASHKISË SË QYTETIT TË ERSEKËS TË MJEDISEVE TË ISH-BRIGADËS SË KËMBËSORISË DHE TË DEGËS SË MOBILIZIMIT, TË CILAT JANË NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja "c", 5,7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ish-brigadës së këmbësorisë dhe të degës së mobilizimit në qytetin e Ersekës, të cilat janë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, t'i kalojnë në pronësi kësaj bashkie, për t'i përdorur për nevojat e komunitetit, për ngritjen e një shkolle të arsimit profesional, të njësive të shërbimit, për apartamente për të pastrehët dhe për muzeun e ushtrisë.

2. Pronat me numër rendor 567 dhe 568 të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhen vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së Ersekës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kryetari i bashkisë së Ersekës të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.228, datë 23.4.2004

PËR RREGULLIMIN E VEPRIMTARISË ME JASHTË TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrinë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor e ushtrojnë veprimtarinë e tyre me jashtë në lidhje e bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Jashtme. Për këtë qëllim, anëtarët e Këshillit të Ministrave, drejtuesit e institucioneve qendrore dhe të organeve të pushtetit vendor ndërmarrin veprime, mbajnë qëndrime dhe bëjnë deklarata, që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me jashtë, duke marrë më parë miratimin dhe udhëzimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

2. Ministrat, drejtuesit e institucioneve qendrore dhe të organeve të pushtetit vendor nuk bëjnë deklarata për probleme të rëndësishme, që kanë të bëjnë me zhvillimet kryesore në rajon apo vende të tjera, në kundërshtim me programin e qeverisë dhe politikën e ndjekur nga Ministria e Punëve të Jashtme.

3. Ministrat, drejtuesit e institucioneve qendrore dhe të organeve të pushtetit vendor në korrespondencën me ambasadorë e përfaqësues të tjerë të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, për çështje me karakter politik ose me rëndësi për marrëdhëniet e shtetit tonë me shtetet e tjera apo organizatat ndërkombëtare, duhet që, brenda 24 orëve, të njoftojnë Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila brenda 48 orëve jep me shkrim mendimin e saj për qëndrimin që duhet mbajtur.

4. Ministrat, drejtuesit e institucioneve qendrore dhe të organeve të pushtetit vendor për veprimtaritë ku marrin pjesë dhe bisedimet që realizojnë me personalitete të huaja, brenda dhe jashtë vendit, të dërgojnë, brenda 15 ditëve nga përfundimi i veprimtarisë, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në Kryeministri, një relacion. Relacioni përmban të dhënat për qëllimin dhe objektin e veprimtarisë për ecurinë e bisedimeve dhe për rekomandimet përkatëse për çështjet e diskutuara. Për çështje të rëndësishme ose urgjente Ministria e Punëve të Jashtme mund ta kërkojë dorëzimin e relacionit edhe brenda një afati më të shkurtër.

5. Ministrinë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor komunikojnë zyrtarisht me përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, të akredituara jashtë vendit, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme.

6. Vizitat zyrtare të anëtarëve të Këshillit të Ministrave jashtë shtetit zhvillohen vetëm pasi Ministri i Punëve të Jashtme të jetë shprehur me shkrim, si dhe pas miratimit nga Kryeministri. Anëtarët e Këshillit të Ministrave, brenda çdo tremujori të paraqesin me shkrim pranë Kryeministrit dhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme planin e vizitave që planifikojnë të kryejnë gjatë tremujorit në vazhdim.

Anëtarët e Këshillit të Ministrave janë të detyruar që, jo më vonë se 15 ditë para datës së nisjes, të paraqesin te Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme, ftesën e marrë dhe kërkesën për realizimin e vizitës, ku të parashtrihen nevojat e kryerjes së kësaj vizite, afati i qëndrimit dhe shpenzimet përkatëse.

Ministri i Punëve të Jashtme, brenda 2 ditëve nga marrja e kërkesës, dërgon mendimin e vet me shkrim, pranë Kryeministrit. Kryeministri i kthen përgjigje me shkrim anëtarit të Këshillit të Ministrave, brenda 3 ditëve pas marrjes së njoftimit nga Ministri i Punëve të Jashtme. Një kopje e kësaj përgjigjeje i dërgohet Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Në rastin e vizitave zyrtare urgjente, të paparashikuara të anëtarëve të Këshillit të Ministrave, miratimi u jepet drejtpërdrejt nga Kryeministri, mbështetur në kërkesën e tyre.

Vizitat private të anëtarëve të Këshillit të Ministrave jashtë shtetit, brenda kohës normale të punës, bëhen pasi të jetë dhënë me shkrim miratimi i Kryeministrit.

Vizitat private të anëtarëve të Këshillit të Ministrave jashtë shtetit, jashtë kohës normale të punës, mund të realizohen vetëm pasi të jetë njoftuar me shkrim Kryeministri.

Shpenzimet e kryera për vizita zyrtare, që zgjasin tej afatit të përcaktuar dhe për të cilat nuk është marrë miratimi i Kryeministrit, nuk përballohen nga shteti.

7. Drejtuesit e institucioneve qendrore dhe të organeve të pushtetit vendor nuk mund të pranojnë ose të refuzojnë ftesa zyrtare nga homologët e tyre, si dhe nuk mund të dërgojnë ftesa zyrtare, pa u këshilluar më parë me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

8. Ministrinë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor, në ushtrimin e veprimtarisë me jashtë, kanë për detyrë:

a) të njoftojnë, menjëherë, Ministrinë e Punëve të Jashtme, për të gjitha problemet me karakter politik, ekonomik apo teknik, që dalin gjatë takimeve të drejtuesve të institucionit me përfaqësues të trupit diplomatik të shteteve dhe me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, të akredituara në Republikën e Shqipërisë apo nga letrat dhe mesazhet që autoritetet e huaja i dërgojnë drejtuesit të institucionit;

b) të organizojnë, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, takimet e drejtuesit të institucionit me homologët e tij, brenda dhe jashtë vendit;

c) të organizojnë protokollin e takimeve të drejtuesit të institucionit me delegacionet e huaja apo me përfaqësues të trupit diplomatik, të akredituar në vendin tonë;

ç) të njoftojnë, çdo tre muaj, për planin e vizitave të delegacioneve të kryesuara nga drejtuesi i institucionit apo nga zyrtarë të lartë, si dhe të delegacioneve të huaja që do të vizitojnë vendin tonë;

d) të dërgojnë, çdo tre muaj, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, një raport të hollësishëm për të gjitha veprimtaritë me jashtë të institucionit, duke përfshirë edhe ecurinë e marrëveshjeve dypalëshe e shumëpalëshe;

dh) të dërgojnë pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të dhëna dhe raportime, sipas kërkesave dhe afateve, për zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare të vendit tonë.

9. Ministria e Punëve të Jashtme ka për detyrë:

a) të njoftojë ministritë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor për veprimtaritë dhe zhvillimet ndërkombëtare, që bëjnë pjesë në sferën e veprimtarisë së tyre;

b) të ndihmojë me materiale, brenda përgjegjësisë së vet, dhe të këshillojë për përgatitjen e vizitave dhe të takimeve të planifikuara të ministrive, institucioneve qendrore dhe organeve të pushtetit vendor;

c) të ofrojë ndihmën e nevojshme ligjore në procesin e lidhjes së traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare nga ministritë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor, në përputhje me dispozitat në fuqi;

ç) t'u komunikojë përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë, kërkesat që vijnë nga institucionet e ndryshme, të cilat i gjykon të arsyeshme;

d) të organizojë, periodikisht, takime të rregullta me drejtuesit e strukturave të marrëdhënieve me jashtë të ministrive dhe institucioneve qendrore për informimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së tyre me jashtë;

dh) të ndihmojë në përcaktimin e qëndrimeve që këto organe duhet të mbajnë brenda sferës së veprimtarisë së tyre, për çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me jashtë;

e) të ndihmojë ministritë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor për njohjen dhe vendosjen e kontakteve me strukturat e ngjashme të shteteve të tjera, si dhe të organizmave ndërkombëtare.

10. Vendimet nr.514, datë 4.9.1995, të ndryshuara, nr.435, datë 20.10.1997, nr.305, datë 1.7.1999 të Këshillit të Ministrave, revokohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.231, datë 23.4.2004

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.393, DATË 15.8.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR SHKODËR-KTHESA VAU I DEJËS (PJESË E SEGMENTIT RRUGOR LEZHË-SHKODËR)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.393, datë 15.8.2002 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 3 të shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Pronarët e pasurive të paluajtshme shtesë, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe 12 250 m² tokë/arë dhe ullishte, 20 m² truall, 93 436 lekë kultura bujqësore, 5 037 200 lekë dru frutorë dhe tre objekte me sipërfaqe ndërtimi 230 m², vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 20 957 640 (njëzet milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekësh.”.

2. Pas pikës 4 të shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Vlera e shpenzimeve procedurale, për pasuritë shtesë, është në shumën 362 348 lekë.”.

3. Pas pikës 5 të shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1. Fondet prej 20 957 640 (njëzet milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekësh, për kompensimin e pronarëve dhe 362 348 (treqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e dyzet e tetë) lekësh, për shpenzimet procedurale, të përballohen nga Buxheti i Shtetit i vitit 2004, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.”.

4. Pas pikës 6 të shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

“6/1. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.5.2004.”.

5. Ngarkohet Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE

Lista e pronareve qe shpronsohen per shkak te ndertimit te segmentit rrugor Lezhe - Shkoder
Seksioni i dyte Kthesa Vau i Dejes - Shkoder

Lloji i pasurise : Are, ullishte, kult.bujq.,dru frutore,truall, ndertese. Nr. 1- 59

Nr. rendor	Pronar			Nr.pas.	Toke are dhe ullishte					Kultura bujq. 14 lek/m2	Dru Frutore ne leke	Truall			Ndertese		Totali ne leke	Shenime
	Emri	Atasia	Mbiemri		Sip. shpr.	VKM Nr 393	Dif. shpr.	Cmimi lek/m2	Vlera ne leke			Sip. m2	Cmimi lek/m2	Vlefte ne leke	Sip. m2	Vlefte ne leke		
1	Tonin	Dede	Pashuku	271/17	210		210	913	191730	2940							194670	
2	Simon	Dede	Pashuku	271/9	540		540	913	493020	7560							500580	
3	Paloke	Dede	Pashuku	271/7	740		740	913	675620	10360							685980	
4	Angjelin	Dede	Pashuku	271/26	300		300	913	273900	4200							278100	
5	Dede	Loke	Pashuku	271/26	300		300	913	273900	4200							278100	
6	Vitor	Dede	Pashuku	271/23	330		330	913	301290	4620							305910	
7	Gjon	Lec	Pjetri	188/4	30		30	913	27390	420							27810	Konfirmim nga Z.Rr.P.P
8	Viktor		Pjetri	188/5	100		100	913	91300	1400							92700	Konfirmim nga Z.Rr.P.P
9	Palok		Pjetri	188/5	100		100	913	91300	1400							92700	Konfirmim nga Z.Rr.P.P
10	Ndoc	Kole	Ndoka	187/2	171	147	24	913	21912	336							22248	
11	Kole	Ndoc	Ndoka	187/1	544	433	111	913	101343	1554							102897	
12	Tom	Dede	Gjergji	388/3	161		161	913	146993	2254							149247	
13	Cin	Gac	Rroku	90/7	225	178	47	913	42911	658							43569	
14	Filip	Gac	Rroku	90/7	225	178	47	913	42911	658							43569	
15	Frano	Gac	Rroku	90/7	225	178	47	913	42911	658							43569	
16	Mark	Tom	Gjergji	90/1	1330	1191	139	913	126907	1946	199300				100	2236432	2564585	
17	Zef	Ejll	Gega	78/10	761		761	913	694793	10654							705447	
18	Kole	Ndoc	Ndoka	69/4	180		180	913	164340	2520							166860	
19	Paulin	Pjeter	Gega	65/5	238		238	913	217294	3332							220626	
20	Paulin	Pjeter	Gega	65/9	325		325	913	296725	4550							301275	mungon kartela e pronesise
21	Pashuk	Ndoc	Gjergji	65/6	165		165	913	150645	2310							152955	
22	Sander	Pashuk	Gjergji	55/6	148		148	913	135124	2072							137196	

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE

Lista e pronareve qe shpronsohen per shkak te ndertimit te segmentit rrugor Lezhe - Shkoder
Seksioni i dyte Kthesa Vau i Dejes - Shkoder

Lloji i pasurise : Are, ullishte, kult.bujq.,dru frutore,truall, ndertese. Nr. 1- 59

N. rendor	Pronar			Nr. pas.	Toke are dhe ullishte					Kultura bujq. 14 lek/m2	Dru Frutore ne leke	Truall			Ndertese		Totali ne leke	Shenime
	Emri	Atesia	Mbiemri		Sip. shpr.	VKM Nr 393	Dif. shpr.	Cmimi lek/m2	Vlera ne leke			Sip. m2	Cmimi lek/m2	Vlefte ne leke	Sip. m2	Vlefte ne leke		
23	Njac	Zef	Gjergji	55/5	165		165	913	150645	2310							152955	
24	Ndrek	Zef	Gjergji	55/4	162		162	913	147906	2268							150174	
25	Rrok	Zef	Gjergji	55/3	120		120	913	109560	1680							111240	
26	Zef	Ejll	Gjergji	55/2	75		75	913	68475	1050							69525	
27	Zef	Kol	Ndoka	51	66		66	913	60258	924							61182	
28	Zef	Kol	Ndoka	30/3	50		50	913	45650	700							46350	
29	Gjergj	Prendush	Prendushi	82/3	300		300	913	273900	4200							278100	
30	Zef	Gjon	Merturi	27/10	75		75	913	68475		76500						144975	
31	Dede	Shuk	Lekaj	27/8	125		125	913	114125		146300						260425	
32	Dede	Mark	Maldakaj	1/8	452		452	913	412676		116000						528676	
33	Adem	Bajram	Miljoja	1/5	200	180	20	913	18260		70000						88260	
34	Faik	Elez	Meta	1/4	432	120	312	913	284856		100500						385356	
35	Brahim	Shaban	Meta	1/3	121	90	31	913	28303		52500						80803	
36	Metush	Musa	Meta	1/2	734	440	294	913	268422		120000						388422	
37	Metush	Musa	Meta	2/3	372		372	913	339636		273500						613136	
38	Hamdi	Shaban	Meta	2/1	3926	2286	1640	913	1497320		805500						2302820	
39	Sherif	Metush	Meta	2/2	880	640	240	913	219120		443000						662120	
40	Enver	Daut	Selimi	90/13	735	507	228	913	208164	3192							211356	
41	Faik	Elez	Meta	90/9	358	277	81	913	73953	1134							75087	
42	Rrok	Zef	Gjonmarkaj	208	1355	640	715	913	652795		233500						886295	
43	Mark	Hile	Furra	207/1	130	120	10	913	9130		31500						40630	
44	Ejll	Simon	Drandofilija	866/7	650	150	500	913	456500		701200						1157700	

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE

Lista e pronareve qe shpronsohen per shkak te ndertimit te segmentit rruqor Lezhe - Shkoder
Seksioni i dyte Kthesa Vau i Dejes - Shkoder

Lloji i pasurise : Are, ullishte, kult.bujq.,dru frutore,truall, ndertese. Nr. 1- 59

Nr. rendor	Pronar			Nr.pas	Toke are dhe ullishte					Kultura bujq. 14 lek/m2	Dru Frutore ne leke	Truall			Ndertese		Totali ne leke	Shenime
	Emri	Atesia	Mbiemri		Sip. shpr.	VKM Nr 393	Dif. shpr.	Cmimi lek/m2	Vlera ne leke			Sip. m2	Cmimi lek/m2	Vlefte ne leke	Sip. m2	Vlefte ne leke		
45	Fran	Filip	Kallmi	866/6	352	186	166	913	151558		226900						378458	
46	Ali	Abdyl	Selmani	866/5	170	50	120	913	109560		100900						210460	
47	Kasem	Abdyl	Selmani	866/4	190	130	60	913	54780		165100						219880	
48	Gezim	Ali	Taipi	866/3					0						60	762420	762420	
49	Xhelal	Met	Milla	30/1					0			20	2141	42820	70	1601082	1787402	
50	Bashkim	Selim	Meti	16/41	299	126	173	913	157949	2422	127100						287471	
51	Enver	Rexhep	Meti	16/40	234	120	134	913	122342	1876	156000						280218	
52	Hajri	Rexhep	Meti	16/39	90	43	47	913	42911	658	113900						157469	
53	Zija	Rexhep	Meti	16/38	10		10	913	9130	140	53300						62570	
54	Rifat	Dyl	Cufi	16/23	20		20	913	18260	280	12000						30540	
55	Rruzhd	Selim	Meti	16/42					0		270700						270700	
56	Rruzhd	Selim	Meti	866/8	420		420	913	383460								383460	mungon kartela e pronesise
57	Kcle		Gjonmarkaj	23/1					0		108100						108100	
58	Daut	Jonuz	Selimi	88/2	114	90	24	913	21912								21912	
59	Gjon	Nikoll	Shkreli								190400						190400	
	Totali				20730	8500	12250		11184250	93436	5037200	20	2141	42820	230	4599934	20957640	

Mbyllet me numer rendor 59 (pesedhjetenente)

Shpenzime procedurale leke 362 348
Vlera totale e shpronasimit leke 21 319 988

VENDIM
Nr.234, datë 16.4.2004

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2004, MIRATUAR PËR MINISTRINË E DREJTËSISË, PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE BUXHETORE, PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT TË PUNËS ME EKSPERTË, PËR REFORMËN NË FUSHËN E DREJTËSISË, "KOMISIONI I REFORMËS LIGJORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, për përballimin e shpenzimeve për ngritjen dhe funksionimin e grupit të punës me ekspertë, për reformën në fushën e drejtësisë, "Komisioni i Reformës Ligjore", në buxhetin e miratuar për vitin 2004, zëri "Shpenzime operative", t'i shtohet fondi prej 6 823 000 (gjashtë milionë e tetëqind e njëzet e tre mijë) lekësh, i ndarë si më poshtë vijon:

- 5 823 000 lekë për shpërblime;
- 1 000 000 lekë për shpenzime për veprimtari dhe publikime të ndryshme.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.8 ,datë 23.4.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Zija Vuci	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 15.03.2004 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh çështjen nr.9 Akti që i përket:

KËRKUES: 1. MUSTAFA KALLÇIU, përfaqësuar nga avokat Lili Robo, me prokurë.

2. ISMET VORPSI, përfaqësuar nga avokat Lili Robo, me deklaram.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: 1. OLEG ARAPI, përfaqësuar nga avokat Fatmir Braka, me prokurë. 2. ARTEMISA ARAPI, përfaqësuar nga avokat Fatmir Braka, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.1618, datë 19.4.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.1138, datë 1.11.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1692, datë 17.10.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit).

BAZA LIGJORE: Neni 131/f i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve të sipërpërmendura:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, në shqyrtimin e çështjes civile midis tyre dhe subjekteve të interesuara, kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor, në kundërshtim me nenin 41/1 të Kushtetutës. Sipas tyre, parregullsia e këtij procesi konsiston në këto drejtime:

Në mosrespektimin e barazisë së armëve midis kërkuesve nga njëra anë dhe subjekteve të interesuara nga ana tjetër.

Të dyja këto gjykata, në kundërshtim me parimet themelore të procesit gjyqësor të parashikuara nga nenet 6 e 16, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, kanë disponuar mbi padinë duke mos u shprehur për atë që u është kërkuar, kanë ndryshuar bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës paditëse.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur në Dhomën e Këshillimit, mospranimin e rekursit, ndonëse aty janë ngritur probleme ligjore dhe ai ishte i detyruar që çështjen ta kalonte për shqyrtim në seancë gjyqësore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Zija Vuci, dëgjoi kërkuesit, subjektet e interesuara, përfaqësuesit e tyre dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur si vijon:

1. Detyrimin e subjekteve të interesuara Oleg e Artemisa Arapi të lirojnë dhe t'u dorëzojnë kërkuesve Mustafa Kallçi u Ismet Vorpsi 4 (katër) dhoma që posedojnë në ish-hotel "Pensioni", të ndodhur në Tiranë, por pasi atyre t'u zgjidhet më parë problemi i strehimit sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve".

2. Detyrimin e të sipërpërmendurve për t'u paguar kërkuesve si pronarë të këtij hoteli shumën prej 1230 lekë, e cila përfaqëson qiranë për periudhën nga dita e ngritjes së padisë më datë 27.9.2001 deri në ditën e kryerjes së ekspertimit më datë 11.3.2002, si edhe qiranë mujore në shumën 2278 lekë për gjithë periudhën nga data 11.3.2002 deri në kohën që do të lirojnë sendin objekt gjykimi. Për pjesën tjetër të padisë ajo ka vendosur rrëzimn e saj.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1138, datë 1.11.2002.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1692, datë 17.10.2003, në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesit Mustafa Kallçi u Ismet Vorpsi.

Gjykata Kushtetuese konstaton se të tre këto vendime nuk janë rezultat i një procesi të rregullt ligjor. Shkelja e kësaj të drejte themelore të parashikuar nga neni 42/1 i Kushtetutës, në gjykatën e rrethit dhe atë të apelit, është shfaqur në këto drejtime:

Së pari, të dyja këto gjykata, në shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje civile nuk kanë respektuar parimin kushtetues për vendosjen e barazisë së armëve midis pjesëmarrësve në proces. Veçanërisht gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, pala paditëse, është vënë në kushte të disfavorshme në krahasim me palën e paditur. Asaj, në mënyrë të shprehur i është mohuar e drejta që nëpërmjet gjykatës të sigurojë provat e nevojshme shkresore ose me dëshmitarë, për të vërtetuar pretendimin që ajo ka ngritur se vërtetimi nr.extra, datë 18.3.1994 i ish- NTSHUS-it Tiranë, i paraqitur si provë nga subjektet e interesuara, nuk ka përmbajtje reale. Një kërkesë e tillë është refuzuar të merret në shqyrtim, sado që kërkuesit paraprakisht kanë parashtruar disa indicie që dëshmojnë për përmbajtjen false të këtij dokumenti. Kështu, ata kanë përmendur faktin se në të është

vënë një vulë që kishte disa vjet që nuk përdorej më, për shkak të ndryshimit të emrit nga Republika Socialiste e Shqipërisë, në Republika e Shqipërisë. Veç kësaj, kërkuesit i kanë bashkuar ankimit për në gjykatën e apelit edhe një deklaratë me shkrim të lëshuar sipas tyre nga Pëllumbesha Ago, ish-drejtoreshë e ndërmarrjes së lartpërmendur, ku thuhet se nga kjo detyrë ajo është larguar rreth dy vjet përpara lëshimit të vërtetimit në fjalë.

Në këto rrethana, gjykata e apelit, duhej t'u krijonte mundësinë kërkuesve, ashtu si dhe subjekteve të interesuara, për të realizuar edhe ata, me mjetet provuese të nevojshme pretendimet e tyre.

Hetimi në këtë drejtim ishte e vetmja rrugë që do të garantonte barazinë e armëve midis palëve të këtij procesi dhe që do ta çonte gjykatën në konkluzione të drejta për çështjen, aq më tepër po të kihet parasysh se vërtetimi nr.extra, datë 18.03.1994, ishte prova e vetme dhe vendimtare mbi të cilën janë bazuar gjykatat në dhënien e vendimeve të tyre.

Një formë tjetër e shkeljes së kësaj të drejte themelore, për proces të rregullt, është edhe ajo e mosrespektimit nga ana e këtyre gjykatave të parimit të disponibilitetit të padisë. Duke mos pasur parasysh kërkesat e neneve 6, 16/2 e 28 të Kodit të Procedurës Civile, ku gjen pasqyrim ky parim kryesor i procesit gjyqësor, të dyja gjykatat kanë vepruar në drejtim të kundërt. Kështu, ato kanë ndryshuar kryesisht, pa pëlqimin e kërkuesve, bazën juridike të padisë, duke e gjykuar atë jo si padi rivendikimi e pronarit jo posedues kundër poseduesit të paligjshëm jo pronar, por si padi që rrjedh nga detyrimet e lindura nga kontrata e qirasë së banesave.

Pra, në këtë rast, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i ka kaluar kufijtë e padisë, sepse ajo është shprehur edhe për gjëra që nuk i janë kërkuar, siç është vërtetimi nga ana e saj i ekzistencës së marrëdhënies juridike të qirasë së banesave midis pjesëmarrësve në proces ose i detyrimit të subjekteve të interesuara t'u paguajnë kërkuesve çmim të reduktuar të qirasë së banesave dhe jo shpërblim për përdorimin e sendit.

Megjithatë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur në Dhomën e Këshillimit, mospranimin e rekursit të ushtruar nga kërkuesit kundër këtyre vendimeve, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

Një vendim i tillë, në kushtet kur dy gjykimet e instancave të tjera gjyqësore janë shoqëruar me shkelje të karakterit kushtetues dhe ndaj tyre nuk është mbajtur qëndrim nga kolegji civil, duhet të shfuqizohet si antikushtetues, ashtu si dy vendimet e gjykatave të tjera.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 e 134 të Kushtetutës, si dhe neneve 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve nr.1618, datë 19.4.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.1138, datë 1.11.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1692, datë 17.10.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Mendimi ynë është i kundërt me arsyetimin e përdorur në këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese. Shumica e përqendron argumentin për pranimin e kërkesës në dy momente që lidhen me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, por nga analiza që u bën parimeve të barazisë së armëve dhe të disponibilitetit rezulton se ajo i ka tejkaluar parametrat e një gjykimi kushtetues, duke e shndërruar këtë qëndrim në një gjykim në thelb të çështjes.

Theksohet në këtë vendim se është shkelur parimi i barazisë së armëve nga të dyja gjykatat, ndërkohë që argumentohet kjo shkelje vetëm për gjykatën e apelit. Sipas saj, parimi i barazisë së armëve është cenuar për arsye se gjykata e apelit e ka refuzuar kërkesën për të marrë në shqyrtim falsitetin e një dokumenti. Ky moment që përbën argumentin kryesor në këtë vendim nuk rezulton nga dosja si një kërkesë procedurale e palës paditëse. Në gjykimin në shkallë të parë, pala paditëse nuk ka pretenduar falsitetin e dokumentit dhe as ka kërkuar kryerjen e ekspertimit për të. Ky pretendim nuk është ngritur as në kërkesën ankimore. Edhe në gjykimin në shkallë të dytë pala paditëse nuk ka kërkuar konform kërkesave që parashikon Kodi i Procedurës Civile goditjen e dokumentit për falsitet.

Në këto kushte, përse kohë që pala paditëse nuk përdor të gjitha mjetet juridike që i njeh ligji për të qenë e barabartë me palën tjetër, nuk mund të pretendohet për cenim të parimit të barazisë së armëve. Detyrë e gjykatës është që t'i krijojë mundësinë palëve për të realizuar mbrojtjen dhe për të zbatuar parimin e kontradiktoritetit në gjykim, por gjykata nuk mund të bëhet aktive për të zgjidhur pretendimet e palëve.

Veç kësaj, për të argumentuar shkeljen e parimit të barazisë së armëve, shumica ka arritur në përfundimin se ky dokument përbën një provë vendimtare për çështjen. Në të vërtetë, nëse një provë është apo jo vendimtare për zgjidhjen e çështjes, ky është një konkluzion që i përshtatet një gjykate të zakonshme, e cila shqyrton thelbin e çështjes dhe jo një gjykim të aspektit kushtetues.

Edhe argumenti për shkelje të parimit të disponibilitetit në gjykim nuk rezulton i bazuar, pasi gjykatat me zgjidhjen që i kanë bërë çështjes kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin. Gjykata është nisur nga marrëdhëniet që ekzistojnë në fakt ndërmjet palëve, që sipas saj ka qenë marrëdhënie ligjore e krijuar ndërmjet një qytetari që ka statusin si i pastrehë dhe pronarit të sendit.

Shumica duke pranuar kërkesën ka shfuqizuar edhe vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të marrë në Dhomën e Këshillimit duke argumentuar se ky kolegji duhej të mbante qëndrim ndaj vendimeve të dy shkallëve të gjyimit që kanë lejuar shkelje të tilla. Ky qëndrim nuk harmonizohet me praktikën që Gjykata Kushtetuese ka mbajtur për çështjet që trajtohen nga kolegjet e Gjykatës së Lartë në Dhomën e Këshillimit.

Konkluzioni ynë përfundimtar për kërkesën e paraqitur është se në rastin në shqyrtim nuk vërtetohet që të jenë shkelur elementet që kanë të bëjnë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Për rrjedhojë një kërkesë e tillë duhej rrëzuar.

Për të gjitha këto arsye ne nuk mund të pajtohemi me qëndrimin e mbajtur në këtë çështje që në tërësinë e tij përbën një devijim dhe nga praktika e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese.

Tiranë, më 23.4.2004

Kryetar: F. Abdiu

Anëtarë: S. Sadushi, K. Peçi

VENDIM
Nr.9, datë 28.04.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Piloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 6.4.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.11 Akti që i përket:

KËRKUES: HALIL DAUTI, përfaqësuar nga avokat Vangjel Kosta, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORI I PËRGJITHSHËM, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.849, datë 21.10.1998 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.332, datë 5.7.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.83, datë 6.2.2002 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi, nëpërmjet avokatit të tij, ka kërkuar në Gjykatën Kushtetuese shfuqizimin e vendimeve të sipërcituara si të papajtueshme me Kushtetutën, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime kryesore:

- Nuk është respektuar në thelb e drejta e mbrojtjes. Avokati i caktuar kryesisht ka mbrojtur dy të pandehur, të cilët kanë pasur papajtueshmëri interesash.

- Nuk është zbatuar parimi procedural i provueshmërisë tej çdo dyshimi të arsyeshëm, duke u prezumuar fajësia e tij që në fillim të procesit.

- është dënuar mbi bazën e provave të marra në mënyrë të kundërligjshme. Nuk është respektuar neni 32/2 i Kushtetutës dhe neni 158 i Kodit të Procedurës Penale.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuarit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R R E N:

Gjykata e Rrethit Tiranë me vendimin nr.849, datë 21.10.1998, ka dënuar kërkuarin me 12 vjet burgim, në mungesë, për veprën penale të vjedhjes me armë në bashkëpunim dhe ka pushuar gjykimin për të pandehurit Ilir Kolldashi dhe Ismet Sokoli. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.332, datë 5.7.2001 dhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.83, datë 6.2.2002.

Gjatë gjykimit në shkallë të parë, gjykata ka caktuar kryesisht një avokat për të mbrojtur të pandehurit Halil Dauti dhe Ilir Kolldashi. Kërkuesi ka pretenduar se ndërmjet dy të pandehurve ka pasur papajtueshmëri interesash në këtë proces dhe se ky veprim i gjykatës ka cenuar rëndë të drejtën e mbrojtjes, pasi, për shkak të individualitetit të qëndrimit, i njëjti avokat nuk mund të realizonte një mbrojtje reale dhe efektive ndaj dy të pandehurve njëkohësisht.

Për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi të kërkuarit, Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme t'i referohet qëndrimit të mbajtur për raste të tilla në jurisprudencën e saj kushtetuese. Kështu është konsideruar shkelje e së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe në veçanti e së drejtës për t'u mbrojtur rasti kur avokati ka mbrojtur njëkohësisht më shumë se dy të pandehur, ndërkohë që ndërmjet tyre ka ekzistuar papajtueshmëria e interesave. Sipas parimeve të rëndësishme kushtetuese e procedurale, Gjykata Kushtetuese duke iu referuar vendimit të saj nr.222, datë 4.11.2002, ka konkluduar se në një proces gjyqësor avokati mbrojtës duhet të veprojë në përputhje me ligjin, standardet dhe etikën e njohur profesionale për të mbrojtur të drejtat e klientit të tij. Kur ai vepron në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrimeve të tij shkel njëkohësisht edhe të drejtën e individit për t'u mbrojtur me avokat.

Nga shqyrtimi i kësaj çështjeje në seancë, si dhe nga studimi i të gjitha materialeve të dosjes gjyqësore që lidhen me pretendimin e mësipërm të kërkuarit, Gjykata Kushtetuese çmon se ndërmjet dy të pandehurve nuk ka pasur papajtueshmëri interesash. Kjo papajtueshmëri nuk rezulton qoftë në lidhjet që të pandehurit kanë pasur me njëri-tjetrin apo me ngjarjen e ndodhur dhe as në faktin se gjykata ka pushuar gjykimin për njërin nga të pandehurit ndërkohë që ka deklaruar fajtor kërkuarin. Avokati i caktuar kryesisht nga gjykata e shkallës së parë me cilësinë e mbrojtësit të dy të pandehurve të gjykuar në mungesë, e ka ushtruar funksionin e tij dhe në veprimet e tij nuk evidentohet që të jenë mbajtur qëndrime të ndryshme në favor apo në disfavor të secilit prej të pandehurve. Në fund të procesit gjyqësor, si dhe në kërkesën ankimore, avokati ka mbajtur të njëjtin qëndrim duke insistuar në pafajësinë e të pandehurve. Gjithashtu pretendimi për papajtueshmërinë e interesave midis dy të pandehurve nuk rezulton që të jetë ngritur si pretendim nga avokati i caktuar më pas nga familjarët në asnjë shkallë gjykimi.

Pretendimin tjetër për zbatim të gabuar të parimit procedural të provueshmërisë tej çdo dyshimi të arsyeshëm, kërkuari e ka bazuar në mënyrën e arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe në analizën e provave që gjykata është përpjekur të bëjë për të provuar fajësinë e tij. Sipas tij, gjykata ka prezumuar fajësinë e kërkuarit duke kryer një analizë provash përjashtuese për dy të pandehurit e tjerë, ndërkohë që nuk ka analizuar pretendimet e tij.

Gjykata Kushtetuese çmon se respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë përbën një ndër elementet e rregullsisë së një procesi gjyqësor. Sipas këtij parimi, gjykatat nuk duhet të fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe ky parim do të konsiderohej i cenuar nëse barra e provës do të kalonte nga akuza tek i pandehuri. Detyrë e gjykatës së zakonshme që shqyrton një çështje penale është që t'i krijojë mundësinë të pandehurit vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të mbrohet dhe ajo të japë vendimin e saj të bazuar mbi provat direkte e indirekte, të cilat duhet të provohen nga akuza dhe që administrohen në dosje.

Në kuptimin që paraqet Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nga qëndrimi që mban jurisprudenca në këtë drejtim, pretendimi për shkeljen e këtij standardi kushtetues kërkon domosdoshmërisht që në një proces gjyqësor të evidentohen dhe provohen saktë të gjithë ato elemente thelbësore, të cilat mund të kenë sjellë deklarimin fajtor të të pandehurit mbi bazën e dyshimeve dhe që e kanë bërë gjykatën të sillet si e njëanshme në dhënien e vendimit të saj.

Nga arsytimi i vendimit gjyqësor nuk rezulton që gjykata të ketë aplikuar dënimin e kërkuarit me bindjen se ai është fajtor që në fillim të procesit dhe pa e mbështetur atë në prova. Në një gjykim të karakterit kushtetues është tepër e rëndësishme, që kur analizohen pretendimet për shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë, të mos përqendrohet kontrolli kushtetues në mënyrën e vlerësimit dhe të çmuarjes së provave që mund t'i ketë bërë në vendimin e saj gjykata që ka gjykuar çështjen në thelb. Nisur nga funksioni i saj, Gjykata Kushtetuese, kur gjykon çështje të kësaj natyre nuk konfondon gjykimin në thelb me gjykimin kushtetues.

Në këto kushte, ajo arrin në konkluzionin se gjykata e faktit në çështjen objekt shqyrtimi nuk e ka gjykuar dhe dënuar kërkuarin vetëm mbi bazën e dyshimeve, por mbi bazën e provave të cilat i kanë analizuar dhe vlerësuar vetë në vendimin e saj.

Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat nuk kanë respektuar nenin 32 pika 1 dhe 2 të Kushtetutës dhe nenin 158 të Kodit të Procedurës Penale, që lidhet me mënyrën e marrjes së provave. Sipas tij prova vendimtare mbi të cilën është bazuar gjykata në shpalljen fajtor ka qenë leximi i thënieve të prindërve të tij të marra gjatë hetimeve paraprake, në të cilat nuk është evidentuar përfitimi i tyre nga e drejta për të mos dëshmuar.

Gjykata Kushtetuese çmon se nuk është detyrë e saj të përcaktojë rëndësinë vendimtare të një prove, si dhe evidentimin e pavlefshmërisë së kësaj dëshmie të marrë gjatë hetimeve paraprake, për sa kohë që gjykatat e zakonshme në arsyetimin e vendimeve të tyre e mbështesin fajësinë e kërkuesit edhe mbi disa prova të tjera. Kuptimi i rregullit kushtetues dhe procedural që parashikohet në nenin 31 pika 1 të Kushtetutës dhe në nenin 158 pika 2 të Kodit të Procedurës Penale, për mundësinë e shtetasve për të përfituar nga e drejta për të mos dëshmuar përpara organeve kompetente lidhet sa me të provuarit, ashtu edhe me garancitë ligjore që u duhet krijuar të pandehurit, si dhe rrethit të personave të afërm me të, për të mos u detyruar dhe ndëshkuar njëkohësisht për dëshmitë që ata japin.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk janë të bazuara dhe për rrjedhojë kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 131 shkronja “f” të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Qëndrimi im nuk mund të jetë i njëjtë me arsyetimin që përdor shumica në vendimin e saj. Arsyet e këtij qëndrimi të kundërt lidhen me konceptet e ndryshme që kemi mbi elementet thelbësore që përcaktojnë parimin e prezumimit të pafajësisë, të paligjshmërisë të marrjes së një prove dhe të së drejtës të të gjykuarit për t’u mbrojtur në mënyrë të përshtatshme dhe të efektshme nga një avokat, qoftë ky edhe avokat i caktuar kryesisht.

Parimi i prezumimit të pafajësisë përbën një ndër elementet kryesore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ky parim parashikohet në Kushtetutë dhe në mënyrë të veçantë është përfshirë si pjesë e nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Nga të gjitha elementet që përfshihen në konceptin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parimi i prezumimit të pafajësisë përbën aspektin më delikat të konfondimit të gjykimit kushtetues me gjykimin në thelb. Duke qenë se kjo përbën një çështje tepër të mpërtë, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në dallim nga ajo e Gjykatës së Strasburgut nuk ka guxuar të eksplorojë në këtë drejtim.

Rasti në shqyrtim përbën një ndër ato raste klasike, kur gjykata hap një proces gjyqësor penal me bindjen se i pandehuri është fajtor dhe ku dënimi i tij nuk bazohet në prova direkte apo indirekte, por në dyshime. Për të analizuar këto momente që prekin parimin e prezumimit të pafajësisë nuk kërkoj të përqendrohem në mënyrën e analizës së provave që ka përdorur gjykata, por do të nisem nga arsyetimi i vendimit të saj për të konkluduar se dyshimet në këtë rast nuk kanë shkuar në favor të të pandehurit. Gjykata, të njëjtës provë mbi të cilën ajo e mbështet arsyetimin e vendimit i ka dhënë kuptim dhe vlerë të ndryshme. Ajo pranon se armën e kanë poseduar dhe përdorur dy të pandehurit njëkohësisht, ndërsa dijeni për të kanë pasur që të tre dhe i përjashton ata nga fajësia, ndërkohë që vetëm mbi këtë provë e cilëson fajtor kërkuesin.

Në rastet e një gjykimi në mungesë barra e provës që i bie prokurorit vështirësohet shumë më tepër se në rastet kur i pandehuri është i pranishëm. Megjithatë, mungesa e të gjykuarit në proces nuk mund të përbëjë një argument më shumë për gjykatën për t'u bindur për fajësinë e tij.

Në vendimin e gjykatës arsyetohet se fajësia e të pandehurit Halil Dauti përforcohet bindshëm edhe nga fakti se ai menjëherë pas kryerjes së veprës penale është larguar në drejtim të paditur. Një konkluzion i tillë është i papranueshëm për standardet që duhet të karakterizojnë procesin gjyqësor. Largimi i të pandehurit nga një gjykim ose mungesa e tij për motive të ndryshme, nuk mund të përbëjë provë për gjykatën për të konkluduar për fajësinë e të pandehurit. Pikërisht mungesa e të pandehurit në gjykim ka ndikuar në krijimin e përshtypjes se gjykatat e kishin formuar paraprakisht idenë për fajësinë e tij.

Ky qëndrim i gjykatës bie ndesh me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe me konceptin që ka krijuar jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut në këtë drejtim. Fajësia e të pandehurit duhet të provohet nga akuzuesi dhe çdo dyshim është në favor të tij. Dënimi i një veprimi ose mosveprimi nuk mund të mbështetet vetëm në elementet objektive të veprës penale, por edhe të arrihet të provohet në çdo rast që i pandehuri ka përmbushur edhe elemente subjektive të veprës penale dhe si rrjedhojë të mund të akuzohet për kryerjen e një vepre penale. Në praktikën e kësaj gjykate¹ është konsideruar si shkelje e nenit 6/2 të KEDNJ deklarimi fajtor i kërkuesit, i cili mbështetej vetëm në dyshime që nuk arritën të provoheshin nga akuza. Neni 6/2 i KEDNJ kërkon që në zbatim të detyrës së tyre gjykatat nuk duhet të fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Barra e provës i bie prokurorit (akuzës) dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Prandaj parimi i prezumimit të pafajësisë do të quhej i cenuar, nëse barra e provës do të kalonte nga akuza tek i pandehuri. Është detyrë e gjykatave të sistemit të zakonshëm të marrin dhe vlerësojnë provat që paraqiten në një proces, kurse Gjykata Kushtetuese ka për detyrë të sqarojë se procedura si e tërë ka qenë ose jo e drejtë në kuptimin kushtetues. Në këtë drejtim respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë nuk bën përjashtim nga koncepti i juridiksionit kushtetues dhe nga e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Shumica nuk e ka pranuar si të drejtë pretendimin e kërkuesit për cenim të së drejtës së mbrojtjes. Në çështjen në shqyrtim, unë kam mendimin se është cenuar në thelb e drejta e mbrojtjes. Avokati i caktuar kryesisht ka mbrojtur dy të pandehur të cilët kanë pasur papajtueshmëri interesash. Ky konkluzion del qoftë nga mënyra e arsyetimit të vendimit gjyqësor, ashtu dhe nga aktet e tjera që ndodhen në dosje.

Papajtueshmëria e interesave është detyrë në radhë të parë për t'u konstatuar nga avokati dhe më pas edhe nga gjykata që shqyrton çështjen. Midis dy të pandehurve kjo papajtueshmëri është evidente për sa kohë që ata kanë qenë në mungesë dhe nga rrethanat e ngjarjes rezulton se kanë individualitete të ndryshme qëndrimi. Kjo reflektohet edhe në zgjidhjen që gjykata ka aplikuar ndaj tyre duke pushuar gjykimin për njërin të pandehur dhe duke deklaruar fajtor kërkuesin. Nga momenti që secili i pandehur përpiket të provojë alibinë e tij, gjë e cila rezulton për kërkuesin, krijohet papajtueshmëria e interesave.

Avokati i caktuar kryesisht nuk e ka realizuar të drejtën e të pandehurit për t'u mbrojtur në mënyrë efektive dhe profesionale. Në procesverbalin gjyqësor e vetmja ndërhyrje e avokatit të caktuar kryesisht është kërkesa e tij që i pandehuri të deklarohet i pafajshëm. Nuk rezulton asnjë pyetje, kërkesë procedurale apo veprime të tjera të nevojshme, por edhe të domosdoshme për realizimin e së drejtës së mbrojtjes në një gjykim penal, ndërkohë që prova vendimtare dhe e vetme për procesin që lidhet me leximet e lejueshme të prindërve rezulton se është marrë në mënyrë të kundërligjshme. Gjatë pyetjeve të prindërve, organet hetimore nuk kanë respektuar kërkesat e nenit 32 pika 1 e 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 158 të Kodit të Procedurës Penale, dispozita të cilat parashikojnë detyrimin e organeve proceduese për t'i bërë të njohur vetë të pandehurit ose të afërmit të tij përfitimin nga e drejta kushtetuese për të mos dëshmuar. Një moment i tillë që merr vlera kushtetuese për procesin penal nuk rezulton të jetë pasqyruar në dosjen gjyqësore. Gjithashtu mosngulmimi i avokatit për të kthyer thëniet e prindërve të kërkuesit në provë, konform kërkesave procedurale, e kanë cenuar në thelb të drejtën efektive të mbrojtjes dhe e kanë

¹ *Telfner. v.Austrisë*

bërë edhe më evidente ekzistencën e papajtueshmërisë së interesave midis të pandehurve. Njëkohësisht, fakti që gjykata nuk ka bërë asnjë përpjekje për të thirrur në seancë gjyqësore dhe për t'i pyetur prindërit e të pandehurit, me qëllim që të garantonte në këtë proces edhe respektimin e nenit 32/1 të Kushtetutës dhe nenit 158 të Kodit të Procedurës Penale, ndikojnë në krijimin e përshtypjes se gjykatat e kanë formuar paraprakisht idenë për fajësinë e kërkuesit.

Këto argumente të parashtruara kanë qenë të mjaftueshme që kërkesa të pranohej dhe vendimet të shfuqizoheshin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Tiranë, më 28.4.2004

Anëtar: S. Sadushi

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004
--

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve

Doli nga shtypi më 10.5.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë